



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

**L I G J**

**(Nr....., datë .....2014)**

**PËR**

**ADMINISTRIMIN E FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR KOMBËTAR NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**KREU I**

**DISPOZITA TË PERGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave, pasuri kombëtare me rëndësi të veçanta, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës dhe tokës, në ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhues, ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime në interes të brezave të sotëm dhe të ardhshëm

**Neni 2**

**Objekti**

1. Objekt i këtij ligji janë administrimi, qeverisja dhe mbrojtja e fondit pyjor e kullosor kombëtar, mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, të pasqyruar në dokumentet

strategjikë dhe angazhimet në kuadrin e konventave, marrëveshjeve, protokolleve dhe traktateve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, për të garantuar përmbushjen në vijimësi të funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale dhe kulturore, në interes të të gjithë shoqërisë.

2. Ky ligj përcakton rregullat, detyrimet, të drejtat, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e institucioneve shtetërore, të njëjsteve të qeverisjes vendore, pronarëve dhe biznesit privat, për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor e kullës kombëtare.

3. Ky ligj përcakton funksionimin e Shërbimit Pyjor si shërbim publik, unifikon sistemin e informacionit të pyjeve dhe kullotave, pavarësisht formës së pronësisë.

4. Fauna e egër, si dhe bimët mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, nuk janë objekt i këtij ligji, por i akteve ligjore e nënligjore të veçantë.

### **Neni 3**

#### **Përkufizime**

Në zbatim të këtij ligji, termit e mëposhtëm, kanë këto kuptime:

1. “Administrimi i pyjeve dhe kullotave” është tërësia e masave organizative, teknike dhe financiare për qeverisjen dhe mbrojtjen e tyre.

2. “autoritet licencues” nënkupton autoritetin e caktuar nga një shtet partner për të lëshuar dhe miratuar licencën FLEGT.

3. “autoritet kompetent” nënkupton autoritetin e caktuar nga shtetet anëtare për të verifikuar licencën FLEGT.

4. “Biodiversiteti pyjor” nënkupton tërësinë e organizmave të gjalla dhe/ose jo , të cilët gjenden brenda fondit pyjor në bashkëveprimin e tyre dhe proceseve ekologjike, pjesë e të cilëve ata janë,ku përfshihet larmia brenda species, ndërmjet specieve, ekosistemeve dhe peisazheve.

5. “Çertifikimi pyjor”, është një deklaratë, me anën e së cilës një palë e tretë, e pavarur, verifikon dhe vërteton se një sistem prodhimi, një produkt apo një shërbim është në përputhje me kërkesat, standardet, specifikimet teknike sipas legjislacionit në fuqi.

6. “Dëmtimi i pyllit dhe mjedisit pyjor”, janë dëmtime me pasoja humbjen e funksioneve të pjesëve të pylli ose mjedisit dhe prishjen e ekuilibrave biologjike natyrore, si rezultat i ndërhyrjeve nga njeriu ose nga faktorë të tjerë natyrore.

7. “Druri dhe produktet e drurit”, janë drurët dhe produktet e drurit të përcaktuar në kodin përkatës doganor dhe/ose në nomenklaturën e kombinuar të mallrave. (rreg. 995/2010, neni 2(a))

8. “Ekosistemi pyjor” është një kompleks dinamik i komuniteteve të kafshëve, bimëve e mikro-organizmave dhe mjedisit të tyre abiotik, që bashkëveprojnë si një njësi funksionale, ku drurët janë një komponent kyç i sistemit. Njerëzit, me nevojat e tyre kulturore, ekonomike dhe mjedisore janë një pjesë integrale e ekosistemeve pyjore.

9. “Ekonomi pyjore” është sipërfaqja e ndarë në ngastra, nënngastra si njësi bazë për drejtimin, organizimin, planifikimin dhe kontrollin e mbarëshhtimit të pyllit dhe që plotëson parimin e vazhdimësisë së prodhimit.

10. “Ekonomi kullosore” sipërfaqja e ndarë në ngastra, nënngastra si njësi bazë për drejtimin, organizimin, planifikimin dhe kontrollin e mbarëshhtimit të kullotës dhe që plotëson parimin e vazhdimësisë së prodhimit kullosor.

11. “Fondi kullosor” është sipërfaqja e kullotave dhe livadheve natyrorë, drurët e shkurret brenda sipërfaqeve të tyre që përdoren për kullotje, të pa përfshira në fondin pyjor, sipërfaqet e zhveshura dhe shkëmbore brenda tyre si dhe infrastruktura përkatëse.

12. “Fondi pyjor” është sipërfaqja me grumbuj pyjorë dhe shkurre, pasuritë jopyjore bashkëshoqëruese, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura (çeltirat, shkëmbinjte, dunat dhe ranishtat), të cilat krijojnë një mjedis me pyjet e tokën pyjore si dhe infrastruktura përkatëse.

13. “Fondi pyjor e kullosor kombëtar”, përfaqësohet nga fondi pyjor e kullosor publik dhe privat.

14. “Inventari Kombëtar i pyjeve dhe kullotave” është procesi që realizon grumbullimin dhe vlerësimin e të dhënave mbi shtrirjen dhe gjendjen e fondit pyjor e kullosor kombëtar, të cilat shërbejnë për hartimin e politikave të planifikimit në fushën e pyjeve dhe kullotave, për zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumëfunksional të tyre.

15. “Kadastra” është sistemi i të dhënave të fondit pyjor e kullosor kombëtar, i organizuar në nivel qendror, rajonal dhe vendor, në të cilin regjistrohen të gjithë informacionet bazë dhe ndryshimet periodike të ndodhura, i shoqëruar me sistemin e informacionit gjeografik (GIS), të nevojshme për administrimin dhe qeverisjen e tij.

16. “Kullotë” është sipërfaqja e tokës, më e madhe se 0,5 ha, me bimësi barishtore natyrore, në formë të qëndrueshme ose me bimësi tjetër, që plotëson kërkesat për kullotje.

17. “Liçencë FLEGT” është dokumenti në të cilin bazohet dërgesa, i një formati standard i cili është rezistent ndaj falsifikimit, ndërhyrjeve të paligjshme dhe i verifikueshëm. Liçenca FLEGT lëshohet për një dërgesë të vetme dhe në përputhje me kërkesat e skemës së liçencimit FLEGT, e lëshuar dhe e miratuar nga autoriteti liçencues i një shteti partner.

18. “Kujdesi i duhur” është sistemi i kujdesit të nevojshëm për parandalimin e tregtimit të paligjshëm të drurit dhe prodhimeve që rrjedhin prej saj.

19. “Livadh” është sipërfaqja e tokës, homogjene, me bimësi barishtore natyrore, që përdoret për kositjen e barit ose për kullotjen e blegtorisë, e që nuk i përket fondit të tokës bujqësore.

20. “Marrëveshje partneriteti” është marrëveshja ndërmjet Komunitetit dhe një shteti partner nëpërmjet së cilës Komuniteti dhe shteti partner marrin përsipër të punojnë së bashku për të mbështetur Planin e Veprimit FLEGT dhe për të zbatuar skemën e liçensimit FLEGT.

21. “Mbarëshhtimi i pyjeve dhe kullotave” është planifikimi afatgjatë për pyjet/kullotat publike dhe private, i cili kryhet mbi bazën e kritereve të caktuar për grumbullimin e informacionit mbi situatën/gjendjen faktike dhe përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme në funksion të statusit të dhënë, me synim përmbushjen e funksioneve ekologjike, ekonomike e sociale, duke zbatuar dhe harmonizuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me nevojat e administruesve, pronarëve privatë dhe përdoruesve të tyre.

22. “Mbrotjtja e pyjeve dhe e tokës pyjore” është veprimtaria për parandalimin e degradimit të pyjeve dhe tokave pyjore nga faktorët njerëzorë e natyrorë, me synim garantimin e ripërtëritjes dhe përmirësimin e burimeve pyjore e jo pyjore bashkëshoqëruese dhe të mjedisit pyjor në tërësi.

23. “Ministria” është ministria përgjegjëse për pyjet dhe kullotat.

24. “Ministër” është ministri përgjegjës për pyjet dhe kullotat.

25. “Nëngastër” është një njësi sipërfaqe me madhësi minimale 0.5 ha që shërben për vlerësimin e grumbujve pyjorë, planifikimin dhe kontrollin e trajtimeve të njehta silvikulturore.

26. “Ngastër” është ndarja e sipërfaqes pyjore dhe kullosore në parcela, me kufij të pandryshueshëm, të cilat shërbejnë si njësi bazë për drejtimin, organizimin, planifikimin dhe kontrollin e mbarështimit.

27. “Njësia e qeverisjes vendore” është Bashkia që ka në pronësi sipërfaqe të fondit pyjor/kullosor brenda kufijve territorial administrativ të saj, e cila është përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor/kullosor publik.

28. “Pasuri pyjore” janë tërësia e elementeve natyrorë të një sipërfaqeje pylli a toke pyjore, me vlera të përdorshme për nevojat e shoqërisë, në të cilët përfshihen toka, drurët, uji, bimësia e shumëllojshme jo pyjore dhe gjallesat e egra.

29. “Përdorues të pyllit/kullotës komunale”, janë familja, grup familjesh, fisi, lagja e fshatit ose fshati, banorët e të cilëve janë me qëndrim të përhershëm në njësinë e qeverisjes vendore, e cila, nga pyjet/kullotat në përdorim ose pronësi të saj, u ka dhënë sipërfaqe të caktuara në përdorim për një periudhë atafgjatë, sipas formës tradicionale të përdorimit ose çfarëdo forme tjetër, në përputhje me vendimin e marrë në bazë të legjislacionit në fuqi.

30. “Përdorim tradicional” është përmbushja e nevojave vetjake të banorëve me qëndrim të përhershëm në njësinë e qeverisjes vendore për dru zjarri për ngrohje, lëndë ndërtimi, kullotje për blegtorinë dhe grumbullim të prodhimeve të dyta.

31. “Pronar privat i pyllit/kullotës” është personi fizik/juridik apo individ, i cili gëzon të drejtat ekskluzive të pronësisë, posedimit, përdorimit, gëzimit, transferimit dhe disponimit të pyllit dhe/ose kullotës, brenda kufijve të caktuar nga ligji.

32. “Plani i mbarështimit” është dokumenti bazë për qeverisjen e pyllit/kullotës, i hartuar për pyllin/kullotën publike ose private, i cili përmban tërësinë e informacioneve mbi situatën e këtyre pasurive natyrore si dhe masat/rekomandimet e nevojshme, të propozuara për trajtimin e tyre, lidhur me objektivat që duhet të realizohen, në funksion të statusit që kanë.

33. “Plani operacional vjetor”, është dokumenti i planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve nga aktivitetet në pyje e kullota, buxheti i shtetit, donacionet ose grantet e ndryshëm, për realizimin e punimeve të përcaktuar ose rekomanduara nga planet e mbarështimit, të veprimtarive për zhvillimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor e kullosor, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së nevojshme, si dhe për qëllime të tjera të parashikuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij..

34. “Prerje kulturore” është tërësia e punimeve të seleksionimit, të rrallimit, të pastrimit, çlirimit, që zbatohen periodikisht në një grumbull pyjor dhe kullosor nga çasti i krijimit deri në shfrytëzimin me synim përmirësimin dhe sigurimin e vazhdimësisë së prodhimit.

35. “Inspektoriati i policisë pyjore” është organ i specializuar me funksione kontrolluese, pjesë organike e inspektoratit shtetëror të ministrisë që mbulon fushën e pyjeve dhe kullotave.

36. “Publiku i interesuar”, ka të njejtin kuptim sipas përkufizimit të ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

37. “Pyll”, është sipërfaqja e tokës, e përfshirë në fondin pyjor, më e madhe se 0,5 ha, me drurë më të lartë se 5 m, të cilët mbulojnë mbi 30 % të saj ose me drurë të aftë për të arritur këto kufij *in-situ*.

38. “Protokoll i Kiotos”, është Protokollin në të cilin Republika e Shqipërisë është palë me ligjin nr. Nr.9334, date 16.12.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e Kiotos të Konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike”

39. “Qeverisje e pyllit” është tërësia e masave të trajtimit dhe shfrytëzimit, të rekomanduara nga plani i mbarështimit, të cilat kanë për qëllim drejtimin e procesit të zhvillimit natyral, pas krijimit të grumbullit të ri e deri në zëvendësimin e gjeneratës së vjetër, në funksion të origjinës së tij.

40. “Ripyllëzim” është mbjellja e drurëve pyjorë në një sipërfaqe të përkufizuar “pyll”, në të cilën për arsye të ndryshme nuk është siguruar ripërtëritja në rrugë natyrore, ose ripërtëritja është dëmtuar dhe nuk garanton zhvillimin e grumbullit të ri, si dhe rimbjellja e drurëve pas aplikimit të prerjeve rrah në të njëjtën sipërfaqe ose rresht.

41. “Skema e liçensimit FLEGT (Zbatimi i Ligji për Pyjet, Qeverisja dhe Liçencimi)”, është tërësia e rregullave për dhënien e liçensës për produktet e drurit që eksportohen nga shtetet partnere në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe zbatimi i skemës sa i takon kontrollit doganor, si pjesë e masave të Planit të Veprimit të BE-së, për luftimin e prerjeve të paligjshme dhe të tregtisë që lidhen me to, për lëndën drurore dhe prodhimet e drurit që importohet nga vendet pjesëmarrëse në këtë skemë.

42. “subjekt”, është personi fizik/juridik i cili ushtron veprimtari: projektuese, zbatuese, tregtare dhe/ose certifikuese, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

43. “Shfrytëzimi i pyjeve” përfaqëson punimet për prerjen dhe nxjerrjen e lëndës drusore nga pyjet dhe shkurret që kanë arritur moshën e shfrytëzueshmërisë, me qëllimin kryesor heqjen e gjeneratës së vjetër dhe krijimin e kushteve për instalimin e gjeneratës së re në rrugë natyrore, gjatë fazave të prerjeve, ose me pyllëzime artificiale për llojet që trajtohen me prerje rrah, si dhe për vlerësimin ekonomik të materialit drusor të përfituar nga prerjet.

44. “shkurre” është bimë drusore shumëvjeçare përgjithësisht më shumë se 0.5 metra dhe më pak se 5 metra e lartë dhe shpesh pa një trung dhe kurorë të përcaktuar.

45. “Shoqatat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave publike” janë bashkimi vullnetar i përdoruesve të pyjeve dhe kullotave publik/privat të krijuar sipas legjislacionit në fuqi.

46. “shtet partner” është shteti ose organizata rajonale që hyn në marrëveshje partneriteti.

47. “Tokë pyjore” është sipërfaqja e tokës, e përfshirë në fondin pyjor, më e madhe se 0.5 ha, me drurë që mbulojnë 5-30 % të saj, ose me një kombinim shkurresh, bimësie pyjore dhe drurësh që mbulojnë 5-30 % të saj.

48. “vendosja në treg i drurit/produkteve të drurit” nënkupton çdo veprimtari që ka për qëllim blerjen dhe shitjen e drurit të papërpunuar ose të produkteve të drurit që rezultojnë nga përpunimi i tij, në tregun e brendshëm apo të jashtëm.

49. “Zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave” është procesi i qeverisjes dhe shfrytëzimit të pyjeve e kullotave, në mënyra dhe intensitete të tillë që të ruajnë larminë e tyre biologjike, prodhimtarinë dhe kapacitetet ripërtëritëse, për të përmbushur tani dhe në të ardhmen funksionet ekologjike, ekonomike dhe shoqërore, pa shkaktuar dëme në ekosistemet e tjerë, si në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe botëror.

## KREU II

### DOKUMENTET POLITIKE DHE TE PLANIFIKIMIT

## **Neni 4**

### **Politika dhe strategjia**

1. Politika e Zhvillimit të Pyjeve dhe Kullotave përfaqëson synimet, prioritetet dhe drejtimit kryesore për zhvillimin afatgjatë e të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, në kuadër të politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore kombëtare, në interes të të gjithë shoqërisë.

2. Politika për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave zbatohet nëpërmjet Strategjisë për Zhvillim e Pyjeve dhe Kullotave, ku përcaktohen synimet strategjike dhe objektivat që duhet të arrihen brenda një periudhe afatgjatë.

3. Politika dhe Strategjia janë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga konventat, marrëveshjet, protokollet dhe traktatet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

4. Politika dhe Strategjia harmonizohen dhe ndërthuren me politikat dhe strategjitë e sektorëve të tjerë, në kuadrin e përgjithshëm, të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

5. Strategjia për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit.

## **Neni 5**

### **Programi Kombëtar i pyjeve dhe kullotave**

1. Programi Kombëtar i Pyjeve dhe Kullotave hartohet në zbatim të Strategjisë së Zhvillimit të Pyjeve dhe Kullotave, për një periudhë 10 vjeçare.

2. Programi Kombëtar i Pyjeve dhe Kullotave formulon masat konkrete për mbarështimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, me qëllim përdorimin shumëfunksional të tyre, bazuar në parimet, standardet dhe kriteret e miratuar nga forumet, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare.

3. Programi Kombëtar i Pyjeve dhe Kullotave gjithashtu përcakton veprimet, buxhetin, afatet dhe detyrat përkatëse, në nivel qendror, rajonal dhe vendor, për institucionet, agjencitë e ndryshme, dhe grupet e interesit, të përfshira në realizimin e tij.

4. Programi Kombëtar i Pyjeve dhe Kullotave përditësohet në vijimësi, gjatë zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Pyjeve dhe Kullotave, në kontekstin e zhvillimeve të përgjithshme dhe të veçanta të vendit dhe të sektorit të pyjeve e kullotave.

5. Miratimi i Programit Kombëtar i Pyjeve dhe Kullotave bëhet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

## **Neni 6**

### **Programi i zhvillimit**

1. Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me pronarët privatë dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit, hartojnë programet në nivel vendor/rajonal të zhvillimit të pyjeve dhe kullotave publike dhe private, në përputhje me Programin Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave.

2. Programi i zhvillimit hartohet bazuar në planet e mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, Inventarin Kombëtar të pyjeve dhe kullotave dhe në dokumentet e tjerë dhe miratohet nga Ministri.

**KREU III**  
**FUNKSIONET, PËRBËRJA, PRONËSIA DHE ADMINISTRIMI I**  
**FONDIT PYJOR E KULLOSOR**

**Neni 7**

**Funksionet e pyjeve dhe kullotave**

1. Pyjet, kullotat e livadhet janë ekosisteme komplekse, që përmbushin funksionet e mëposhtëm:

- a. ekologjike, nëpërmjet ruajtjes dhe përmirësimit të potencialeve prodhues, ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike, regjimit hidrik, parandalimit dhe frenimit të dukurisë së gërryerjes, përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe zbutjes së klimës;
- b. ekonomike, nëpërmjet vjeljes së prodhimeve drusore, jodrusore, gjahut, grumbullimit të bimëve mjekësore, aromatike e eterovajore, përdorimit të pasurive të tjera natyrore dhe zhvillimit të veprimtarive tregtare;
- c. sociale, nëpërmjet zhvillimit të veprimtarive argëtuese, çlodhëse, sportive, turistike, edukative, për mbrojtjen e shëndetit, trashëgimisë natyrore e kulturore dhe aspekteve të tjerë mjedisore e estetikë.

2. Pyjet gjithashtu kontribuojnë në procesin e përvetimit (sekuestrimit) të karbonit. Ministria është organi përgjegjës për zbatimin e dispozitave të Protokollit të Kiotos dhe marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

**Neni 8**

**Klasifikimi i pyjeve**

1. Në varësi të qëllimeve që caktohen për të përmbushur, pyjet klasifikohen:

- a. prodhues, funksioni i të cilëve është prodhimi i lëndës drusore;
- b. mbrojtës, funksioni i të cilëve është së pari mbrojtja e tokës nga gërryerja, rrëshqitjet, përmytjet, mbrojtjen nga erërat të tokave bujqësore, stabilizimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së regjimit ujor;
- c. të mbrojtur, funksioni i të cilëve është përmbushja e qëllimeve të përcaktuar në statusin e dhënë.

2. Pjesë të fondit pyjor, kullosor, livadhet e tokat pyjore, të cilat përfshihen në Rrjetin e Zonave të Mbrojtura, menaxhohen sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi për zonat e mbrojtura.

3. Klasifikimi i pyjeve, në funksion të qëllimeve që duhet të përmbushin, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, bëhet mbi bazën e kriterëve të përcaktuar me udhëzim të Ministrit.

4. Krijimi i rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë, ruajtja dhe trajtimi i pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër, si dhe kalimi i tyre në konservim të plotë, bëhen në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.

**Neni 9**

**Klasifikimi i kullotave**

1. Kullotat, livadhet dhe sipërfaqet me drurë e shkurre ose me bimësi pyjore, që përdoren për kullotje, të pa përfshira në fondin pyjor, sipas periudhës së përdorimit, klasifikohen në:
  - a. kullota verore;
  - b. kullota dimërore.
2. Klasifikimi i kullotave dhe livadheve bëhet në përputhje me kriteret teknike të përcaktuar me udhëzim të Ministrit.

## **Neni 10**

### **Përbërja e fondit pyjor e kullosor**

1. Fondi pyjor e kullosor kombëtar përbëhet nga pyjet dhe kullotat e livadhet, sipas përcaktimeve të mëposhtëm.
2. Fondi pyjor kombëtar përbëhet nga këto formacione bimore e jobimore:
  - a. pyjet dhe drurët pyjorë;
  - b. shkurret;
  - c. bimësia barishtore, mjekësore, eterovajore e tanifere natyrale;
  - d. tokat me bimësi pyjore, sipërfaqet e zhveshura, shkëmbinjtë, dunat e ranishtat që ndodhen brenda sipërfaqeve pyjore;
  - e. fidanishtet pyjore;
  - f. infrastruktura rrugore, pritat, lerat, koritat, çezmat, rrethimet apo gardhimet në zonat e mbrojtura, në pyjet me funksion të veçantë, në rezervatet e gjuetisë, shenjat e ndryshme treguese të mbarështimit, të ndërtuara nga shërbimi pyjor, njësia e qeverisjes vendore, pronari privat, apo të dhëna në pronësi të tyre.
3. Fondi kullosor kombëtar përbëhet nga:
  - a. kullotat dhe livadhet;
  - b. bimësia barishtore, mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore;
  - c. sipërfaqet me drurë, shkurre ose bimësi pyjore që përdoren për kullotje, të pa përfshira në fondin pyjor;
  - d. infrastruktura rrugore, hauzet, lerat, çezmat, koritat;
  - e. sipërfaqet shkëmbore në përbërje të kullotave.
4. Në fondin pyjore e kullosor kombëtar nuk përfshihen, por administrohen sipas dispozitave të këtij ligji:
  - a. drurët e veçantë dhe grupet e drurëve, kudo që ndodhen, kur sipërfaqja që mbulojnë nuk plotëson kriterin për t'u konsideruar pyll, si dhe ata që ndodhen në një rresht rreth tokave bujqësore, anës rrugëve, kanaleve, vijave të ujit, brezat erëmbrojtës;
  - b. paraqet urbanë dhe sipërfaqet e pyllëzuara pranë monumenteve dhe varrezave, pavarësisht nga sipërfaqjet e tyre.

## **Neni 11**

### **Pronësia**

1. Pyjet, kullotat e livadhet në territorin e Republikës së Shqipërisë janë pasuri kombëtare.
2. Fondi pyjor e kullosor kombëtar, përbëhet nga:



- a. Fondi pyjor dhe kullosor në pronësi publike pronë e paluajtëshme e njësive të qeverisjes vendore për sipërfaqet brenda kufijve territorial administrativ;
  - b. Fondi pyjor dhe kullosor në pronësi publike pronë e paluajtëshme e ministrisë, që është pjesë e rrjetit të Zonave të Mbrojtura të Republikës së Shqipërisë;
  - c. Fond pyjor dhe kullosor në pronësi privat të personave fizikë/juridikë.
3. Kuotat e karbonit, në procesin e përvetimit të tij, u përkasin pronarëve, sipas pronësisë që kanë mbi fondin pyjor.

## **Neni 12**

### **Administrimi i fondit pyjor e kullosor kombëtar**

1. Në varësi të formës së pronësisë fondi pyjor dhe kullosor, administrohet nga:
  - a. njësitë e qeverisjes vendore, për fondi pyjor e kullosor brenda kufijve territorial administrativ;
  - b. ministria për fondin pyjor dhe kullosor që është pjesë e rrjetit të Zonave të Mbrojtura të Republikës së Shqipërisë;
  - c. pronarët privatë, pyjet dhe kullotat e livadhet në pronësi të tyre;
2. Njësia e qeverisjes vendore ngre strukturën e saj për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullosor brenda kufijve territorial administrativ me personel inxhiniero-teknik me arsim pyjor. Numri i nëpunësve në strukturën e administrimit të fondit pyjor dhe kullosor përzgjidhet në funksion të sipërfaqes si vijon:
  - a. Një nëpunës për 750 – 1000 ha për pyjet e lart;
  - b. Një nëpunës për 1500 – 2500 ha për pyjet e ulët dhe shkurre;
  - c. Një nëpunës për 4000 – 6000 ha për kullota dhe livadhe.
3. Njësia e qeverisjes vendore, bashkëpunon me shoqërinë civile dhe strukturat e shërbimit pyjor, për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor e kullosor të marrë pronësi.
4. Kriteret dhe procedurat e administrimit të fondit pyjor e kullosor kombëtar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.
5. Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor kombëtar bëhet sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, pavarësisht formës së pronësisë.

## **KREU IV**

### **KADASTRA E FONDIT PYJOR E KULLOSOR KOMBËTAR**

#### **Neni 13**

#### **Kadastra Kombëtare**

1. Pyjet, kullotat e livadhet, së bashku me infrastrukturat përkatëse, regjistrohen në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nga pronarët e tyre, sipas dispozitave të legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, përfaqëson regjistrin zyrtar dhe bazën e të dhënave, në të cilin pasqyrohet tërësia e informacioneve të nevojshme për administrimin dhe qeverisjen e fondit pyjor e kullësor kombëtar, shoqëruar me sistemin e informacionit gjeografik (GIS).

#### **Neni 14**

##### **Organizimi i Kadastrës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave**

1. Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave organizohet në bazë të kriterëve teknike, që mundësojnë evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve të ndodhura në mënyrë periodike, në fondin pyjor e kullësor kombëtar.

2. Ministria është institucioni përgjegjës për mbajtjen e të dhënave kadastrale për fondin pyjor e kullësor kombëtar

3. Njësitë e qeverisjes vendore mbajnë të dhënat kadastrale për fondin pyjor dhe kullësor public dhe privat brenda territorit të tyre administrative dhe i përditësojnë ato në mënyrë periodike.

4. Pronarët privatë mbajnë të dhënat kadastrale ose u'a delegojnë mbajtjen e të dhënave njësisë së qeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhen pyjet, kullotat dhe livadhet që kanë në pronësi.

5. Pronari privat dhe njësia e qeverisjes vendore raportojnë në Ministri për ndryshimet përkatëse në fondin pyjor dhe kullësor në muajin Janar dhe Qershor të çdo viti.

6. Baza e të dhënave të Kadastrës së Fondit Pyjor dhe Kullësor Kombëtar, mënyra e mbajtjes së të dhënave kadastrale në nivel vendor, rajonal dhe qendror, informacioni që duhet regjistruar, si dhe afatet e përgatitjes dhe raportimit nga administratorët dhe/ose pronarët e pyjeve dhe kullotave, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrit.

#### **KREU V**

##### **MBROJTJA E FONDIT PYJOR E KULLËSOR KOMBËTAR**

#### **Neni 15**

##### **Mbrojtja e fondit pyjor dhe kullësor kombëtar**

1. Mbrojtja e pyjeve, mjedisit pyjor dhe e kullotave nga dëmtimet që ndikojnë në ekuilibrin ekologjik të tyre, është detyrim i përhershëm dhe përgjegjësi ligjore e të gjitha strukturave shtetërore, njësisive të qeverisjes vendore, pronarëve privatë dhe personave fizikë a juridikë, vendas e të huaj, që zhvillojnë veprimtari në fondin pyjor e kullësor kombëtar. Mbrojtja e tyre bazohet në dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Mbrojtja e fondit pyjor e kullësor kombëtar nga dëmtimet, prerjet ose kullotjet pa leje, sëmundjet, insektet, zjarret, shkatërrimi, pushtimi apo tjetërsimi i paligjshëm, si dhe çdo element tjetër i cili dëmton apo ka gjasa të dëmtojë, përfshirë veprat hidroteknike, pritat malore dhe gardhet, veprat e ujit të pijshëm për blegtorinë, lerat, hauzet, koritat, çezmat, të cilët ndodhen brenda fondit pyjor e kullësor kombëtar e që shërbejnë për zhvillimin dhe mbrojtjen e tij, është detyrim i përhershëm e të gjitha strukturave shtetërore, njësisive të

qeverisjes vendore, pronarëve privatë dhe personave fizikë a juridikë, vendas e të huaj, që zhvillojnë veprimtari në fondin pyjor e kulllosor kombëtar.

3. Luftimi i sëmundjeve, dëmtuesve dhe insekteve në fondin pyjor e kulllosor kombëtar në rastet e forcës madhore, organizohet nga njësitë e qeverisjes vendore dhe pronarët privatë, ndërsa fondet e nevojshme përballohen nga buxheti i shtetit.

## **Neni 16**

### **Veprimtari në fondin pyjor dhe kulllosor kombëtar**

1. Në fondin pyjor dhe kulllosor kombëtar ndalohen:

- a. ndryshimi i destinacionit të veprave të ujit të pijshëm për blegtorinë;
- b. dëmtimi i infrastrukturës pyjore dhe kulllosore si rrugë dhe veprave ujore;
- c. kullotja dhe kalimi i bagëtive në pyllëzimet e reja, në pyjet me filizëri natyrore të instaluar, në pyjet e ricunguar, në pyjet mbrojtëse e me funksione të veçantë, në rezervatet e gjetisë e të mbarështimit të faunës së egër dhe në ato farorë.
- d. prerja pa damkë e drurëve;
- e. prerja e filizërisë dhe e fidanëve në fidanishte;
- f. ndezja e zjarreve jashtë vendeve ta caktuara;
- g. nxjerrja e rrënjëve shqopës, bushit, maresë dhe prerja e thuprës së shelgut dhe llojeve të tjerë të drurëve pyjorë gjatë periudhës së vegjetacionit;
- h. mbledhja e prodhimeve të dyta mjekësore, eterovajore e tanifere të rralla e të kërcënuara jashtë peridhës teknike të vjeljes;
- i. kullotja e bagëtive në ngastrat eksperimentale dhe në sipërfaqe ku kryhen punime përmirësuese;
- j. përdorimi i çekiç-damkës nga persona të paautorizuar
- k. prishja e shenjës së damkës ne dru;
- l. ngritja e ndërtimeve të thjeshta, gardhimeve, kampingjeve, parkimi i automjeteve dhe vendosja e rulotave në pyjet me funksion mbrojtës;
- m. tregtimi i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera të pyjeve dhe kullotave të infektuara nga sëmundjet, barërat e këqija e parazitaret osë të prekura nga insektet;
- n. ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i veprimtarive që shkaktojnë degradim dhe gërryerje të tokës pyjorë/kulllosore;
- o. prishja, fshirja ose dëmtimi i shenjave kufijdëftuese, gjeidezike e topografike, i tabelave paralajmëruese e treguese;
- p. hedhja e mbetjeve jashtë vendeve të caktuara;
- q. shkarkimi i kimikiateve dhe ujrave të ndotur industrialë.

2. Ndalohet kryerja pa leje e veprimtarive të mëposhtme:

- a. prerja e pyjeve, brezave pyjorë mbrojtës, drurëve të veçuar dhe e shkurreve;
- b. nxjerrja dhe grumbullimi i prodhimeve drusore dhe jo drusore;

- c. nxjerrja e rrënjëve shqopës, bushit, maresë dhe prerja e thuprës së shelgut dhe llojeve të tjerë të drurëve pyjorë
  - d. mbledhja e prodhimeve të dyta mjekësore, eterovajore e tanifere të rralla e të kërcënuara
  - e. krasitja për gjethe, kositja dhe grumbullimi i barit në fondin pyjor/kullosor/livadhe, kullotja, kositja e barit në livadhe, pastrimi i kullotave dhe livadheve, ndërhyrjet për pasurimin dhe përmirësimin e bimësisë dhe kapaciteteve të kullotave dhe livadheve;
  - f. përdorimi i plehrave kimike dhe i pesticideve;
  - g. ndërhyrjet me punime në dunat bregdetare, pjesë e fondit pyjor dhe kullosor publik;
  - h. ndërhyrjet për pyllësim apo pasurimin dhe përmirësimin e bimësisë së tokave pyjore;
  - i. ndërtimi i furrave të gëlqeres dhe i kaminave të qymyrit të drurit;
  - j. ngritja e ndërtimeve të thjeshta, gardhimeve, kampingjeve, parkimi i automjeteve dhe vendosja e rulotave;
  - k. nxjerrja e gurëve, plisave, rrënjëve, cungjeve, marrja e dheut, rërës dhe zhavorrit.
3. Lejen për ushtrimin e veprimtarive të pikës 2 më lart jepen nga njësia e qeverisjes vendore nëpërmjet strukturës administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji, sipas formateve të miratuara me urdhër të ministrit.

## **Neni 17**

### **Monitorimi**

1. Për ndjekjen dhe evidentimin në vijimësi të ndryshimeve që pësojnë pyjet, kullotat e livadhet nga ndotjet atmosferike, dëmtuesit, sëmundjet, zjarret e faktorë të tjerë, me ndikime në treguesit e ekosistemeve pyjore e kullosore, të biodiversitetit, si dhe marrjen e masave të nevojshme e të përshtatshme për ripërtëritjen e qeverisjes normale të tyre, organizohet rrjeti i përhershëm i monitorimit të fondit pyjor e kullosor kombëtar.

2. Rrjeti i përhershëm i monitorimi i fondit pyjor e kullosor kombëtar është pjesë e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit, të përcaktuar në nenin 42, të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.

3. Programi i monitorimit të fondit pyjor dhe kullosor kombëtar, metodika për grumbullimin e informacioneve, analizimin, interpretimin, organizimin e sistemit të të dhënave dhe raportimin e tyre, si dhe kriteret dhe indikatorët për vlerësimin e secilit komponent të përfshirë në monitorim, hartohen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në bashkëpunim me institucionet shkencore të vendit, njësitë e qeverisjes vendore dhe është pjesë e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit, referuar nenit 41 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.

4. Në programin e monitorimit përfshihen të gjithë komponentët që i nënshtrohen monitorimit, tërësia e elementëve të nevojshëm për secilin prej tyre si dhe sistemi i të dhënave që mundësojnë paraqitjen e gjendjes dhe prirjeve të proceseve për çdo komponent.

5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit monitoron në vijimësi fondin pyjor e kullosor kombëtar sipas përcaktimit në pikën 1 të këtij neni, përpunon dhe nxjerr rezultatet e monitorimit, harton

dhe boton raportin vjetor për gjendjen e fondit pyjor e kullësor kombëtar si pjesë të Raportit për Gjendjen e Mjedisit.

## **KREU VI**

### **TRAJTIMI DHE ZHVILLIMI I FONDIT PYJOR E KULLËSOR**

#### **Neni 18**

##### **Mbarështimi i pyjeve e kullotave**

1. Mbarështimi i pyjeve bazohet në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, i cili përfshin kriteret e mëposhtme:

- a. mirëmbajtja dhe përmirësimi i duhur i burimeve pyjore dhe kontributi i tyre në ciklet globale të karbonit;
- b. mirëmbajtja e vitalitetit dhe shëndetit të ekosistemeve pyjore;
- c. mirëmbajtja dhe nxitja e funksioneve prodhuese të pyjeve (drusore dhe jo-drusore);
- d. mirëmbajtja, konservimi dhe përmirësimi i përshtatshëm i diversitetit biologjik në ekosistemet pyjore;
- e. mirëmbajtja, ruajtja dhe përmirësimi i përshtatshëm i funksioneve mbrojtëse në menaxhimin e pyjeve (sidomos tokës dhe ujit);
- f. mirëmbajtja e kushteve dhe funksioneve të tjera social-ekonomike.

2. Mbarështimi i pyjeve dhe kullotave është përgjegjësi e administruesve dhe/ose pronarëve të tyre.

3. Mbarështimi i fondit pyjor dhe kullësor publik bazohet në Planin e Mbarështimit dhe Planin Operacional dhe realizohet nga persona juridikë/fizikë publik ose privat, për fondin pyjor dhe kullësor publik në pronësi të njësisë të qeverisjes vendore dhe nga pronari privat për fondin pyjor dhe kullësor privat.

#### **Neni 19**

##### **Plani i mbarështimit**

1. Plani i mbarështimit është dokumenti zyrtar dhe instrumenti për realizimin e qeverisjes, zhvillimit dhe mbrojtjes së pyjeve dhe kullotave, i vlefshëm për një periudhë 10 vjeçare. Hartimi i planeve të mbarështimit i nënshtrohet procedurës së vlerësimit strategjik mjedisor në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Planet e mbarështimit hartohen bazuar në metodikat e përgatitura nga Ministria. Metodika, procedura për shqyrtimin deri në miratimin e planeve të mbarështimit miratohet me Udhëzim të Ministrit.

3. Plani i mbarështimit i pyjeve dhe kullotave hartohet nga struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji ose nga persona fizikë/juridik privat të certifikuar sipas kodit III.7.A të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të cilët plotësojnë kriteret si vijon:

- a. Për personat fizik:
    - i. Të kenë arsimin përkatës pyjor, të diplomuar në nivelin ciklit e dytë dhe/ose të tretë të studimit, sipas nenit 26 të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
    - ii. Të kenë përvojë në fushën e pyjeve, jo më pak se 5 vite, duke e dokumentuar me kopje të noteruar të librezës së punës.
  - b. Për personat juridik:
    - i. Drejtuesi teknik i personit juridik të ketë arsimin përkatës pyjor dhe të jetë i diplomuar në nivelin ciklit e dytë dhe/ose të tretë të studimit, sipas nenit 26 të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me përvojë pune jo më pak se 5 vite, duke e dokumentuar me kopje të noteruar të librezës së punës.
4. Shpenzimet e nevojshme për kryerjen e planeve të mbarështimit, përballohen me:
    - a. Financim të njësisë së qeverisjes vendore për pyjet dhe kullotat publik;
    - b. Fondet e veta për pyjet dhe kullotata private.
  5. Plani i mbarështimit në parim përmban dhe rekomandon:
    - a. gjendjen e pyjeve dhe kullotave në periudhën kur hartohet;
    - b. masat për përdorimin e qëndrueshëm dhe trajtimin e tyre, me synim ruajtjen dhe përmirësimin e funksioneve ekonomike, mjedisore, ekologjike dhe shoqërore, si dhe për ndërtimin e mirëmbajtjen e infrastrukturës së nevojshme.
  6. Shqyrtimi i planit të mbarështimit për fondin pyjor dhe kullor publik dhe privat bëhet nga komisionet teknike të ngritur pranë cdo njësi të qeverisjes vendore sipas përcaktimeve në udhëzimin e parashikuar në pikën 2 të këtij neni dhe plani i përcillet për miratim Ministrit. Plani i Mbarështimit i miratuar vihet në dispozicion të publikut.
  7. Plani i mbarështimit përditësohet në vijimësi, për të pasqyruar ndryshimet që ai pëson, si rezultat i zbatimit të punimeve dhe ndërhyrjeve që kryhen në fondin pyjor e kullor, si dhe nga shkaqe ose faktorë të ndryshëm. Përditësimi dhe rishikimi i planit të mbarështimit i nënshtrohet procedurë sipas Udhëzimit referuar në pikën 2 të këtij neni.

## **Neni 20**

### **Plani operacional**

1. Plani operacional është përmbledhja e mundësive konkrete të kapaciteteve të produkteve drusore dhe jo drusore, kullotave, bimëve medicinale si edhe parashikimi i investimeve dhe bilanci vjetor i të ardhura dhe shpenzime për një vit kalendarik për fondin pyjor dhe kullor publik në territorin administrativ të njësisë së qeverisjes vendore.
2. Plani operacional vjetor për aktivitetet vjetore në pyje dhe kullota hartohet bazuar në të dhënat e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave për vitin referues në plani e mbarështimit. Plani operacional miratohet nga Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore.
3. Plani operacional :
  - a. për fondin pyjor dhe kullor publik hartohet nga struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji.
  - b. për pyjet dhe kullotat private hartohet nga vetë pronari.

4. Metodika e hartimit të Planit Operacional është pjesë e rregullave dhe procedurave të administrimit të pyjeve dhe kullotave publik dhe privat sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministratve referuar në pikën 4 të nenit 12 të këtij ligji.

#### **Neni 21**

##### **Inventari Kombëtar i pyjeve dhe kullotave**

1. Inventari Kombëtar i pyjeve dhe kullotave kryhet nga Ministria jo më pak se një herë në 10 vjet.
2. Procedurat, kriteret dhe metodika për kryerjen e Inventarit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave miratohen me Udhëzim të Ministrit.
3. Inventari Kombëtar i pyjeve dhe kullotave miratohet me Urdhër të Ministrit.

#### **KREU VII**

##### **TRAJTIMI DHE SHFRYTËZIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE**

#### **Neni 22**

##### **Trajtimi i pyjeve dhe kullotave**

Trajtimi i pyjeve dhe kullotave bazohet në masat dhe rekomandimet e planifikuara në planet e mbarështimit, nëpërmjet planeve operacionale vjetore, të cilët zbatohen nga strukturat që administrojnë pyjet, kullotat dhe livadhet publike, pronarët privatë, si dhe nga të gjithë personat juridikë e fizikë, që zhvillojnë veprimtari në fondin pyjor e kullosor kombëtar.

#### **Neni 23**

##### **Shfrytëzimi i pyjeve**

1. Vëllimi i materialit drusor që do të shfrytëzohet çdo vit, planifikohet brenda mundësisë vjetore të shfrytëzimit, të fondit pyjor kombëtar, bazuar në planet e mbarështimit. Këtij vëllimi i shtohet edhe vëllimi i materialit drusor me vlerë ekonomike, i planifikuar nga prerjet kulturore si edhe nga dëmtimet si rezultat i katastrofave natyrore ose zjarret.
2. Planifikimi i mundësisë vjetore të shfrytëzimit dhe vëllim i materialit drusor që do të rezultojë nga punimet kulturore:
  - a. për fondin pyjor dhe kullosor publik hartohet nga struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji.
  - b. për pyjet dhe kullotat private hartohet nga vetë pronari.
3. Ministri miraton me Urdhër, mundësinë vjetore të shfrytëzimit për pyjet publik dhe privat në përputhje me të dhënat e planit operacional vjetor.
4. Shfrytëzimi i fondit pyjor publik e privat, organizohet në bazë të vitit pyjor, i cili fillon në datën 1 tetor dhe përfundon në datën 30 shtator të vitit pasardhës.

5. Në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale, shfrytëzimi lejohet edhe në periudhën e vegjetacionit, duke respektuar kriteret teknike të vendosur në Vendimin e Këshillit të Ministrave referuar në pikën 2 të nenin 32 të këtij ligji.

6. Prerja e drurëve në fondin pyjor kombëtar, bëhet pas shënimit të tyre me damkë. E drejta e damkimit, administrimi dhe mënyra e përdorimit të çekiç damkës përcaktohet me udhëzim të Ministrit.

7. Subjektet që kryejnë aktivitetin e shfrytëzimit të pyjeve në fondin pyjor publik dhe privat, shënojnë me bojë të paheqshme dhe vendosin etiketa në prodhimet e tyre, sipas kriterëve të vendosur në në Vendimin e Këshillit të Ministrave referuar në pikën 2 të nenin 32 të këtij ligji.

8. Struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji, monitoron periodikisht prodhimet drusore të realizuara nga subjektet që shfrytëzojnë pyjet, bën rakordimet për përputhshmërinë e vëllimit të prodhimeve me vëllimin e lëndës së kontraktuar.

## **Neni 24**

### **Përdorimi i kullotave**

1. Përdorimi i kullotave publike dhe private, kryhet duke zbatuar rekomandimet e planit të mbarështimit, për:

- a. kohën e hyrjes dhe të daljes së bagëtive;
- b. aftësinë mbajtëse, për të mos lejuar mbikullotjen;
- c. kullotjen racionale.

2. Përrjashtohen përkohësisht nga kullotja, ngastrat e kullotave dhe livadheve;

- a. eksperimentale;
- b. ku kryhen punime përmirësuese;
- c. të degraduara.

3. Në veprat e ujit të pijshëm, lerat, hauzet, koritat dhe çezmat, të ndërtuara në fondin kullosor publik lejohet të pinë ujë të gjitha tufat e bagëtive, pavarësisht se kontratat për kullotjen e tyre nuk janë lidhur me administruesit ose pronarët e kullotave ku ato ndodhen.

4. Kriteret teknike për përdorimin e kullotave, përcaktohen me Udhëzim të Ministrit.

## **Neni 25**

### **Pyllëzimet dhe punime të tjera në fondin pyjor e kullosor**

1. Pyllëzimet artificiale kryhen në tokat me bimësi pyjore, sipërfaqet e zhveshura, të gërryera dhe ranishtat, pjesë e fondit pyjor e kullosor publik dhe privat.

2. Për pyllëzimet artificiale, krahas llojeve autoktonë, përdoren edhe lloje drurësh e shkurresh me rritje të shpejtë, të vlefshëm për industrinë e përpunimit dhe për nevoja energjetike.

3. Ripyllëzimet kryhen në sipërfaqet pyjore të dëmtuara nga shkaqe të ndryshëm dhe ku nuk është siguruar ripërtëritja në rrugë natyrore, sipërfaqet ku filizëria e instaluar është djegur e dëmtuar dhe nuk garantohet zhvillimi i grumbullit të ri, si dhe në sipërfaqet ose brezat pyjorë që trajtohen me pyllëzime artificiale dhe prerje rrah.



4. Sistemimet malore, që përfaqësohen nga gardhet dhe pritrat, ndërtohen për frenimin e dukurisë së gërryerjes, në sipërfaqet e fondit pyjor e kulllosor kombëtar, ku kjo dukuri është e pranishme.

5. Sistemimet malore, sipas nevojave dhe kushteve konkrete, shoqërohen edhe me pyllëzimin e shpateve të ujëmbledhësve, përrenjve dhe përroskave.

6. Lerat, hauzet, koritat dhe çezmat, ndërtohen në kullota e livadhe, pavarësisht formës së pronësisë, për sigurimin e ujit të pijshëm për blegtorinë.

## **Neni 26**

### **Planifikimi i punimeve**

1. Planifikimi për vitin pasardhës për të gjithë llojet e punimeve në fondin pyjor e kulllosor kombëtar bëhet në përputhje me rekomandimet e planeve të mbarështimit.

2. Planifikimin e punimeve në fondin pyjor e kulllosor publik e bën struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji, në bashkëpunim me shoqatën e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave.

3. Pronarët privatë e bëjnë vetë planifikimin e punimeve.

4. Manuali i zërave, normave të punës dhe çmimet përkatëse, përbën referencën për hartimin e preventivave të planifikimit të fondeve të shpenzimeve dhe inestimeve në fondin pyjor dhe kulllosor kombëtar. Manuali i zërave, normave të punës dhe çmimet përkatës në pyje e kullota miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e ministrit..

## **Neni 27**

### **Hartimi dhe miratimi i projekteve**

1. Projektet tekniko-ekonomikë të zbatimit hartohen për realizimin e masave të rekomanduara ose të planifikuara nga planet e mbarështimit, për trajtimin e pyjeve dhe kullotave, si dhe për punimet e tjera dhe ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme.

2. Projektet tekniko-ekonomikë hartohen nga struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji dhe subjektet privatë, sipas formës së pronësisë/përdorimit ose nëpërmjet personave fizikë/juridikë të çertifikuar, sipas pikës 3 të nenit 19 të këtij ligji.

3. Miratimi i projekteve për punimet në pyjet e kullotat publike e private bëhet nga titullari njësisë së qeverisjes vendore.

4. Hartimi i projektet tekniko-ekonomikë bazohet në metodikat dhe kriteret e përcaktuar, me udhëzim të Ministrit.

5. Projektet tekniko-ekonomikë i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **KREU VIII**

### **PRODHIMET E FONDIT PYJOR E KULLOSOR**

## **Neni 28**

### **Klasifikimi i prodhimeve**

1. Prodhimet e fondit pyjor e kullosor kombëtar, klasifikohen:
  - a. drusore, ku përfshihen lënda e punimit, drutë e zjarrit, fashinat, shkarpat, thuprat, cungjet, petavrat, rrënjët e drurëve, kuckat, hunjtë, bandierat dhe lëvorja.
  - b. jo drusore, ku përfshihen lulet, frutat, farat, sythat, bisqet, degët, drurët dekorativë, shpatullat, kalamat, gjetet, halat, boçet, zhukat, kallamishtet, rrëshira, plisat, bari, rrënjët, zhardhokët, kërpudhat, myshqet, humusi, lëgusha, torfa, dhëu, gurët, zhavorri dhe rëra.
2. Prodhimet drusore dhe jo drusore, të përfshirë në pikën 1 të këtij neni, përjashtuar lëndën e punimit e drutë e zjarrit quhen prodhime të dyta.
3. Para grumbullimit të prodhimeve të dyta, bëhet planifikimi i kontingjenteve, brenda mundësive prodhuese e biologjike të rekomanduara nga plani i mbarështimit dhe në përputhje me kriteret e vendosur në planin operacional vjetor sipas përcaktimeve në nenin 20 të këtij ligji.
4. Standartet kombëtare për kriteret teknike që duhet të plotësojnë asortimentet që rezultojnë nga lënda e punimit dhe drutë e zjarrit miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për Ekonominë dhe ministrit.

## **Neni 29**

### **Shërbimet në ekosistem**

1. Shërbimet në ekosistem, janë përfitime që sigurohen nga funksionet natyrore të pyjeve dhe kullotave dhe punimet e kryera, për:
  - a. mbrojtjen e tokës nga dukuria e gërryerjes;
  - b. përvetimin (sekuestrimin) e karbonit;
  - c. përmirësimin e sasisë dhe cilësisë së ujit;
  - d. mbrojtjen e biodiversitetit.
2. Rregullat për përfitimet nga shërbimet në ekosistem, kompensimi dhe pagesat miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit.

## **KREU IX**

### **ÇERTIFIKIMI, PROMOVIMI, MARKETINGU, TREGTIMI I LËNDES DRUSORE**

## **Neni 30**

### **Çertifikimi pyjor dhe i prodhimeve drusore e jo drusore**

1. Për çertifikimin e pyjeve publikë dhe privatë, njësitë e qeverisjes vendore dhe pronarët privatë kanë të drejtë të aderojnë në një sistem çertifikimi, në funksion të përputhshmërisë së tyre me kriteret e atij sistemi. Sistemet e çertifikimit miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e ministrit.

2. Çertifikimi i pyjeve, prodhimeve drusore dhe jo drusore, bëhet nga subjekte të akredituar sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 31**

#### **Promovimi dhe marketingu**

1. Elementët e marketingut të lëndës drusore dhe jo drusore përfshijnë: çmimin, llojin/et e produktit/eve;, vend-ndodhjen dhe promovimin me mënyra e mjete të ndryshme.

2. Struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji:

- a. ndërton bazën e të dhënave të prodhimeve drusore dhe jo drusore të shitura me çmimin e e vendndodhjen e tyre dhe të shërbimeve të ofruar në pyje e kullota, së bashku me tarifën, çmimet apo vlerat përkatëse.
- b. monitoron në vijimësi kërkesë-ofertën në treg dhe çmimet e produkteve drusore të papërpunuar, gjysmë të përpunuar dhe të përpunuar, të produkteve jo drusore dhe shërbimeve të ndryshme në pyje e kullota dhe i reflekton ato në bazën e të dhënave.
- c. Promovon vlerat e shumëfishta të fondit pyjor e kullosor kombëtar, nevojën për mbrojtjen dhe zhvillimin e tij, nëpërmjet mënyrave dhe mjeteve të ndryshme të publikimit dhe të informimit nga pronarët.

### **Neni 32**

#### **Tregtimi i lëndës drusore, çmimet dhe tarifën**

1. Shitja e lëndës drusore nga njësitë e qeverisjes vendore, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për ankandet, në dy mënyra:

- a. në këmbë;
- b. me asortimente, në anë të rrugës.

2. Rregullat për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe jo-drusor, si dhe kategorizimi i rrugëve autopajore, përdorimi dhe standartet teknike të tyre, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e ministrit.

3. Të drejtat që sigurohen nga kontrata për trajtimin dhe shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar, nuk u transferohen të tretëve.

4. Pronarët privatë kanë të drejtë të shesin materialin drusor pa ankand duke respektuar rregullat e vendimit të Këshillit të Ministrave referuar në pikën 2 të këtij neni sa i takon trajtimin, shfrytëzimit dhe transportit të materialit drusor dhe jo drusor.

5. Çmimet dhe tarifën për prodhimet drusore, jo-drusore, kullosore, dhënien në përdorim, heqjen nga fondi pyjor/kullosor dhe vlera e dëmeve në fondin pyjor dhe kullosor kombëtar miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e Ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat.

6. Pronarët privatë, për aktivitetet që zhvillohen në fondin pyjor/kullor në pronësi të tyre, kanë të drejtë të përdorin çmimet/tarifat në fuqi ose çmime/ tarifa të tjera, të vendosura në marrëveshje me subjektet e interesuar.

7. Në funksion të ndryshimeve që pësojnë çmimet e tregut të lëndës drusore, të prodhimeve të dyta dhe të shërbimeve, çmimet indeksohen periodikisht.

8. Shitja e lëndës drusore në këmbë bëhet në ngastrat dhe nënngastrat që përshkohen ose jo nga rrjeti rrugor pyjor, në të cilat janë damkosur paraprakisht drurët që do të priten. Shitja e lëndës drusore në këmbë në ngastra dhe nënngastra që nuk përshkohen nga rrjeti rrugor pyjor realizohet sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave referuar në pikën 2 të këtij neni.

9. Projekti i shfrytëzimit hartohet nga subjekti që ka fituar të drejtën e trajtimit dhe shfrytëzimit të ngastrës/ngastrave dhe miratohet nga titullari i njësisë së qeverisjes vendore..

10. Shitja e lëndës drusore me asortimente të gatshëm, organizohet për materialin drusor të depozituar në anë të rrugës.

11. Asortimente drusore në formën e trupave dhe lënda tjetër e punimit në formë të rumbullakët, ndahen në grupe sipas cilësisë dhe shënohen copë për copë me bojë të paheqëshme dhe etiketa.

12. Drutë e zjarrit dhe asortimentet e ngjashëm me to, stivohen në grupe sipas kritereve të vendosur në vendimin e Këshillit të Ministrave referuar në pikën 2 të këtij neni.

13. Tregëtimi i lëndës drusore të papërpunuar dhe të përpunuar, bëhet sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjorë në zbatim të tij.

14. Shitja e lëndës drusore të papërpunuar dhe të përpunuar, me destinacion tregun e brendshëm, shoqërohet me dokumentacionin përkatës, që vërteton prodhimin e tyre në përputhje me rregullat e miratuara më Vendim të Këshillit të Ministrave referuar pikës 2 të këtij neni.

15. Rastet e ndalimit të eksportit të lëndës së drurit të papërpunuar, lëndës së ndërtimit, druve të zjarrit dhe asortimentet që rrjedhin nga tjetërsimi i tyre, si edhe qymyrit të drurit, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit.

16. Subjektet që veprojnë në tregun e drurit zbatojnë sistemin “kujdesi i duhur”, për të parandaluar tregtimin e lëndës drusore të prerë në mënyrë të paligjëshme dhe të prodhimeve që rrjedhin prej saj. Rregullat dhe procedurat për zbatimin e këtij sistemi miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

17. Shitësi dhe blerësi i lëndës drusore të papërpunuar e të përpunuar, janë të detyruar të vërtetojnë origjinën e ligjëshme të saj, nëpërmjet kontratave dhe dokumentacionit tjetër plotësues ligjor.

18. Titullari i njësisë së qeverisjes vendore dërgon për miratim pranë Ministrit, hartën vjetore të shfrytëzimit të pyjeve për vitin pasardhës, brenda muajit dhjetor të çdo viti. Procedurat e ankandit fillojnë pas miratimit nga Ministri.

**KREU X**  
**PERDORIMI I FONDIT PYJOR E KULLOSOR KOMBËTAR**

**Neni 33**

**E drejta e përdorimit**

1. Përdorimi i fondit pyjor e kullosor ka për qëllim plotësimin e nevojave ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit në përgjithësi dhe të banorëve të zonave rurale e pronarëve privatë në veçanti, nëpërmjet prodhimeve dhe shërbimeve që ofrojnë, pa cënuar aftësitë e tyre ripërtëritëse.

2. Të drejtën e përdorimit të pyjeve dhe kullotave publike dhe private e kanë administruesit ose pronarët e tyre, subjektet e autorizuar prej tyre si dhe subjektet që e kanë fituar këtë të drejtë, si rrjedhojë e një veprimi juridik.

3. Marrëdhëniet ndërmjet administruesve ose pronarëve të pyjeve dhe kullotave dhe personave juridikë e fizikë, rregullohen nëpërmjet kontratave noteriale, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjerë ligjorë e nënligjorë, në fuqi.

**Neni 34**

**Përdorimi i pyjeve dhe kullotave publike**

1. Pjesë të fondit pyjor e kullosor publik jepen në përdorim për zhvillimin e veprimtarive për:

- a. fidanishte, baza didaktike-eksperimentale dhe punë kërkimore-shkencore në fushën e pyjeve dhe kullotave;
- b. mbarështimin e florës, kultivimin dhe grumbullimin e bimëve të ndryshme;
- c. mbarështimin e faunës së egër dhe zhvillimin e gjuetisë turistike e sportive;
- d. agropylltari dhe akuakulturë,
- e. kullotjen e blegtorisë dhe kositjen e barit;
- f. ndërtime të përkohshme në kullota si shtëpi verimi për blegtorët, depo, stane, objekte të përpunimit të bulmetit, etj;
- g. qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive dhe kulturore;
- h. nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte në karrierë;
- i. vendosjen e antenave të telefonisë fikse, të lëvizshme, televizive, radio-komunikacionit, instalimin e teleferikëve stacionarë (pasagjerësh ose mallrash), sheshet e ndërtimit të shtyllave të të tensionit të lartë;
- j. ndërtimin e parqeve energjetikë, aerogjeneratorëve dhe objekteve të ndryshëm industrialë;
- k. ndërtimin e rrugëve automobilistike, hekurudhave dhe aeroporteve;
- l. kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, hidrokarbureve dhe të ujit;

- m. shtrirjen në thellësi dhe sipërfaqe të tubacioneve të ujit, naftës, gazit, të linjave të tensionit të lartë, ndërtimin e kanaleve, rrugëve ndihmëse të përkohëshme për lidhjen e sipërfaqeve të marra në përdorim me rrjetin rrugor ekzistues,
  - n. vendosje kaminash për prodhimin qymyrit të drurit dhe eshkës së kovaçit, furrë gëlqereje, sheshe për depozitimin e përkohshme të materialeve të ndryshme (pika transiti);
  - o. zhvillimin e manovrave ushtarake ose zbatimin e projekteve në interes të mbrojtjes kombëtare.
2. Dhënia në përdorim e pjesëve të fondit pyjor dhe kullor publik bëhet sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, ankandet dhe konçesionet e partneritetin publik privat.
  3. Gërmimet në fondin pyjor e kullor publik për nxjerrjen e humusit, plisave të barit, gurëve, rërës, zhavorrit, vendosja e kaminave për prodhimin e qymyrit të drurit, eshkës së kovaçit dhe të furrave të gëlqeres, për karriera që përdorin lëndë plasëse ,bëhen me miratim paraprak të strukturës administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji.
  4. Qëndrimi i automjeteve, rulotëve dhe vendosja e çadrave në fondin pyjor e kullor publik, bëhet vetëm në vendet e caktuar nga struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji sipas rregullave të miratuara me Udhëzim të Ministrit.
  5. Njësia e qeverisjes vendore që ka në pronësi pjesë të fondit pyjor e kullor publik ka si qëllim parësor plotësimin e nevojave të banorëve të saj me dru zjarri, material ndërtimi, nëpërmjet punimeve të përmirësimit dhe shfrytëzimit të tyre, për kullotje dhe sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë dhe grumbullimin e prodhimeve të dyta.
- Pjesë të fondi pyjor dhe kollosor publik u jepen banorëve të njësive të qeverisjes vendore me qëndrim të përhershëm, për grumbullimin e prodhimeve të dyta, dru zjarri, lëndë ndërtimi dhe kullotje për nevojat e tyre të përdorimit tradicional sipas tarifave në fuqi.
6. Kriteret teknike për grumbullimin e prodhimeve të dyta, druve të zjarrit, lëndës së ndërtimit dhe për kullotjen dhe produktet e kullotjes miratohen me udhëzim të Ministrit.
  7. Kullotat e livadhet jepen për përdorim të përkohshëm kullor pa të drejtë përsëritje për të njejtën sipërfaqe, me afat deri në 3 vjet.
  8. Përdorimi për një periudhë nga 3 deri 10 vjeçare, jepet në rastet kur personi juridik ose fizik, nëpërmjet një plani investimesh merr përsipër kryerjen e investimeve për përmirësimin e kullotës dhe të infrastrukturës së saj, plan i cili përfshihet në detyrimet kontraktore ndërmjet palëve.
  9. Dhënia në përdorim e kullotave dhe livadheve bëhet në përputhje me aftësitë mbajtëse kullorore, të përcaktuar në planin e mbarështimit për çdo ngastër ose nënngastër.
  10. Personi fizik ose juridik, që ka marrë kullotë apo livadh për kullotje ose kositje, nuk ka të drejtë t'u a japë atë apo pjesë të saj, të tretëve me nënkontratë.
  11. Shfrytëzimi i pyjeve nga personat fizikë ose juridikë, lejohet vetëm pasi të jetë garantuar plotësimi i nevojave të banorëve të njësisë vendore, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 5 të këtij neni.

12. Njësia e qeverisjes vendore ka të drejtë të japë në përdorim sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave të marra në pronësi, për aktivitetet e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

### **Neni 35**

#### **Përdorimi i fondit pyjor dhe kullor privat**

1. Pronari privat ka të drejtë të përdorë pyllin/kullotën në pronësi të tij, për plotësimin e nevojave vetjake ose për qëllime përfitimi ekonomik, konform dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjorë në zbatim të tyre.

2. Trajtimin dhe shfrytëzimin e pyllit, mbledhjen e prodhimeve të dyta dhe kullotjen në pronën e tij, pronari privat mund ta kryejë vetë ose nëpërmjet personave juridikë e fizikë..

3. Pronari privat ka të drejtë të japë në përdorim pyllin/kullotën në pronësi të tij, për aktivitetet e parashikuar për fondin pyjor e kullor publik, në pikën 1 të nenit 34, duke respektuar të njëjtat rregulla dhe detyrime, përjashtuar ato financiare.

4. Vendet për zhvillimin e aktiviteteve të parashikuar në pikat 3 dhe 4 të nenit 34, caktohen nga vetë pronari i pyllit ose kullotës.

5. Pronari privat njofton Inspektoriatin e Policisë Pyjore për shkeljet dhe dëmtimet e konstatuara në pyllin dhe kullotën e tij.

### **Neni 36**

#### **Ndryshimi i destinacionit të fondit pyjor e kullor**

1. Nga kadastra e fondit pyjor e kullor kombëtar hiqen sipërfaqe, të cilave u ndryshohet destinacioni fillestar duke u kthyer në troje për zgjerimin e vijave kufizuese të qendrave të banuara si dhe për veprimtaritë e parashikuara në gerrat “h” deri “l”, pika 1, të nenit 34.

2. Heqja e sipërfaqeve nga fondi pyjor e kullor kombëtar, bëhet për:

- a. pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, sipërfaqet e zhveshura dhe çeltirat, me sipërfaqe deri 100 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave;
- b. pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, sipërfaqet e zhveshura dhe çeltirat, me sipërfaqe mbi 100 ha, me ligj të veçantë;
- c. kullotë e livadh me sipërfaqe deri 100 ha me vendim të Këshillit të Ministrave;
- d. kullotë e livadh me sipërfaqe mbi 100 ha, me ligj të veçantë.

3. Për sipërfaqet që hiqen nga fondi pyjor dhe kullor kombëtar subjektet përfitues janë të detyruar, që me mjetet e tyre financiare, të investojnë për pyllëzimin/ripyllëzimin për sipërfaqen e hequr të fondit pyjor dhe kullor sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave referuar pikës 6 të këtij neni.

4. Sipërfaqja e kërkuar për ndryshim destinacioni miratohet edhe nëse veprimtaria e planifikuar për t’u zhvilluar nuk është e parashikuar në Planet e Menaxhimit dhe Planet Operacionale.

5. Për sipërfaqet e djegura të pyjeve dhe kullotave, ndalohet ndryshimi i destinacionit të tyre, për një periudhë 10 vjeçare.

6. Procedurat dhe dokumentacioni përkatës për heqjen e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor dhe kullor kombëtar, për dhëniën në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit.

7. Ndryshimet e destinacioneve të pyjeve, tokave pyjore, sipërfaqeve të zhveshura, kullotave dhe livadheve, pasqyrohen në rregjistrin e kadastrës pyjor dhe kullor, pas miratimit nga organi kompetent.

8. Nuk konsiderohen ndryshime destinacioni, sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave që zihen nga ndërtimi i rrugëve pyjore dhe i infrastrukturës tjetër të nevojshme për administrimin e fondit pyjor e kullor publik dhe privat.

9. Kur në fondin pyjor e kullor publik merret vendim nga Këshilli Kombëtar i Territorit, për ndryshim të destinacionit të këtij fondi, njësa e qeverisjes vendore dhe Ministria përditësojnë rregjistrin kombëtar të kadastrës së pyjeve dhe kullotave, për sipërfaqet pyjore/kullor kombëtar objekt i vendimit.

### **Neni 37**

#### **Veprimtaritë**

1. Veprimtaritë e shërbimeve dhe punimeve dhe veprimtaritë kërkimore e shkencore për trajtimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor e kullor, zhvillohen nga personat juridikë e fizikë, shoqatat e ndryshme, institucionet arsimore dhe kërkimore shkencore.

2. Kryerja e shërbimeve e ekspertizës profesionale dhe e veprimtarive sipas pikës 1 të këtij neni bëhet pas pajisjes me çertifikatën përkatëse, sipas përcaktimeve referuar në pikën 3 të nenit 19 të këtij ligji.

## **KREU XI**

### **INFRASTRUKTURA RRUGORE**

### **Neni 38**

#### **Planifikimi, projektimi dhe ndërtimi i rrjetit rrugor**

1. Planifikimi i rrjetit rrugor në fondin pyjor e kullor publik dhe privat bëhet nga struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji dhe pronarët privatë dhe miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore.
2. Projektimi i rrugëve pyjore, brenda fondit pyjor e kullor publik dhe privat bëhet nga:
  - a. struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat publik, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji ose,
  - b. subjektet të çertifikuar sipas pikës 3 të nenit 19 të këtij ligji,
3. Rrugët pyjore, brenda sipërfaqeve pyjore e kullor publike dhe private, ndërtohen me mjetet financiare të Buxhetit të Shtetit, të njësisë së qeverisjes vendore dhe pronarët privat.



4. Njësia e qeverisjes vendore dhe pronari privat në marrëveshje me njeri-tjetrin bashkojnë fondet për ndërtimin e një rruge pyjore, që përkrah sipërfaqet e pyjeve/kullotave në administrim, përdorim ose pronësi të tyre. Në këto raste kontributet e palëve do të jenë në raport të drejtë me vëllimet e punimeve të secilit segment të saj, që do të kalojnë në sipërfaqet respektive sipas pronësisë.
5. Ndërtimi i rrugëve pyjore, në fondin pyjor e kullosor kombëtar, realizohet nga subjekte të licensuar, nëpërmjet procedurave të parashikuara nga legjislacioni përkatës. Pronarët privatë kanë të drejtë të bëjnë përzgjedhjen e subjektit pa tenderim.
6. Për marrjen e lejeve, ndërtimin, supervizimin, kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të rrugëve pyjore, ndiqen procedurat e parashikuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
7. Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve pyjore është detyrë e administruesve dhe pronarëve të pyjeve dhe kullotave.
8. Personat juridikë ose fizikë që kanë marrë pyje në përdorim sipas legjislacionit në fuqi ndërtojnë, riparojnë dhe mirëmbajnë rrugët pyjore me mjetet e tyre financiare.

### **Neni 39**

#### **Përdorimi i rrjetit rrugor**

1. Rrugët pyjore janë pjesë e fondit pyjor e kullosor kombëtar dhe përdorimi i tyre është shumfunksional.
2. Administruesit dhe pronarët e pyjeve dhe kullotave përdorin rrjetin rrugor për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave publike dhe private.
3. Administruesit dhe pronarët e pyjeve dhe kullotave kanë të drejtë të vendosin post-bloqe për monitorimin e hyrjes së mjeteve në rrugët që kanë ndërtuar vetë në sipërfaqet ose pjesë të caktuara të sipërfaqeve, në administrim, përdorim apo pronësi të tyre.
4. Lejohet qarkullimin e mjeteve dhe i njerëzve në rrugët pyjore nëse nuk ekzistojnë rrugë të tjera të lidhura me rrjetin kombëtar ose lokal, për qarkullimin e mjeteve dhe të njerëzve.
5. Njësitë e qeverisjes vendore dhe pronarët privatë lejojnë hyrjen e vizitorëve dhe mjeteve në pyje dhe kullota, të destinuara për qëllime pushimi, argëtimi, shoqërore, turistike, sportive., kundrejt tarifave në fuqi.
6. Ministria, Inspektoriatet si dhe strukturat e tjera shtetërore kanë të drejtë të kalojnë pa asnjë kufizim në rrjetin rrugor të pyjeve dhe kullotave publike dhe private.
7. Në raste zjarresh, katastrofash natyrore ose manovrash ushtarake, lejohet pa asnjë kufizim hyrja e mjeteve dhe e njerëzve në fondin pyjor e kullosor kombëtar.

## **KREU XII**

### **ZJARRET**

## **Neni 40**

### **Parandalimi i zjarreve**

1. Ndalohet ndezja e zjarreve në pyje dhe kullota publike dhe private, në tokat e tjera në afërsi të tyre, si dhe çdo veprim tjetër që përbën burim ose shkak për ndezjen e pa kontrolluar të tyre.
2. Në pyjet, kullotat e livadhet dhe veçanërisht në pjesët e tyre të destinuara për aktivitetet çlodhëse, argëtuese, sportive, tregtare, pavarësisht nga format e pronësisë, në vende të ndryshme e të përshtatëshme të terrenit shkruhen ose vendosen tabela këshilluese për mos ndezjen e zjarreve si dhe për mbrojtjen e tyre nga zjarret.
3. Vizitorët , informohen dhe këshillohen për mbajtjen nën kontroll gjatë gjithë kohës dhe fikjen plotësisht të tyre në përfundim të aktiviteteve. Nëpërmjet tabelave që vendosen në afërsi të vendeve ku lejohet ndezja e zjarreve.
4. Për parandalimin e zjarreve në fondin pyjor e kullor kombëtar, njësia e qeverisjes vendore nëpërmjet strukturës administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji dhe pronarët privat, organizojnë sistemin e vrojtimit-sinjalizimit.
5. Struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji dhe pronarët privat, çdo vit hartojnë planin për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, për sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullor kombëtar në territorin administrativ, ku përfshijnë mjetet që kanë në dispozicion si dhe numrin e personave të organizuar në njësitë e posaçme për këtë qëllim. Plani për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve miratohet nga titullari i njësisë së qeverisjes vendore, brenda muajit mars.

## **Neni 41**

### **Zjarret e kontrolluar**

1. Në pyjet, kullotat e livadhet apo pjesë të tyre të destinuara për aktivitete çlodhëse, argëtuese, sportive, lejohet ndezja e zjarreve vetëm në vendet e caktuar nga administruesit ose pronarët e tyre.
2. Zjarre të kontrolluar në pyje, kullota e livadhe ndizen nga struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji dhe pronari privat, në sipërfaqet në pronësi të tyre kur është domosdoshmërisht e nevojëshme.
3. Për çdo rast struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji ose pronari privat, hartojnë kërkesën për nevojën e ndezjes së zjarreve të kontrolluar, si dhe planin e menaxhimit, në të cilin jepen të detajuara të gjitha fazat e procesit si dhe mjetet në dispozicion për mbajtjen nën kontroll dhe shuarjen e tyre. Shpenzimet për ndezjen e zjarreve të kontrolluar i përballon subjekti që ka paraqitur kërkesën. Miratimi i kërkesës bëhet nga titullari i njësisë së qeverisjes vendore.
4. Njësia e qeverisjes vendore dhe pronari privat informon dhe marrin pëlqimin e stacioneve të mbrojtjes nga zjarri përkatës, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri.
5. Rregullat dhe kriteret për ndezjen, monitorimin dhe fikjen e zjarreve të kontrolluar përcaktohen në udhëzim të Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe Ministrisë.

## **Neni 42**

### **Regjistri i zjarreve**

1. Për evidentimin e zjarreve të rënë në pyjet dhe kullotat publike dhe private, struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji krijon Regjistrin e Zjarreve.

2. Regjistri i Zjarreve organizohet për evidentimin e zjarreve, përfshirë edhe zjarret e kontrolluar dhe raportimin e informacioneve, në nivel vendor, rajonal dhe qendror.

3. Struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji dhe pronari privat, ose subjekti të cilit i është deleguar administrimi, evidentojnë zjarret e rënë në pyjet dhe kullotat që administrojnë apo kanë në pronësi dhe raportojnë të dhënat statistikore, në përputhje me kriteret e vendosur në përputhje me përcaktimet e Vendimit të këshillit të Ministrave referuar në pikën 6 të nenit 14 të këtij ligji.

## **Neni 43**

### **Shuarja e zjarreve**

1. Shuarja e zjarreve të rënë në fondin pyjor e kullësor kombëtar është detyrë e njësive të qeverisjes vendore, pronarëve privatë, subjekteve që zhvillojnë aktivitete në këtë fond, reparteve ushtarake dhe e strukturave të tjera shtetërore të ngarkuara me ligj.

2. Fondet për shuarjen e zjarreve përballohen nga struktura që ka në administrim, përdorim ose pronësi pyllin apo kullotën ku ka rënë zjarri.

3. Për shuarjen e zjarreve, njësitë e qeverisjes vendore dhe pronarët privatë, ngrenë njësi të posaçme dhe bashkëpunojnë ndërmjet tyre, me dhe strukturat e tjera shtetërore, sipas detyrimeve të përcaktuara sipas legjisllacionit në fuqi.

## **KREU XIII**

### **INFORMIMI, PJESEMARRJA E PUBLIKUT DHE SHERBIMI KESHILLIMOR**

## **Neni 44**

### **Informimi**

1. Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, nëpërmjet mjeteve dhe mënyrave të ndryshme të komunikimit, kanë për detyrë të publikojnë dhe të japin informacione për:

- a. të dhënat kadastrale të fondit pyjor e kullësor publik dhe privat;
- b. rezultatet e monitorimit të pyjeve dhe kullotave;
- c. rezultatet e Inventarit Kombëtar të pyjeve dhe kullotave;
- d. ndryshimet e destinacionit të fondit pyjor e kullësor;
- e. gjuetinë, shitjen e lëndës drusore dhe prodhimeve jo drusore;
- f. dëmet në pyje e kullota nga veprimtaritë e ligjshme dhe të pa ligjshme;
- g. situatat e zjarreve, katastrofat natyrore në pyje, masat që merren dhe rezultatet e arritura;

- h. të ardhurat dhe investimet e planifikuara dhe të realizuara;
  - i. projektet e planifikuar dhe të realizuar;
  - j. aktet ligjorë e nënligjorë të propozuar dhe të miratuar;
  - k. aktivitetet kombëtare;
  - l. pjesëmarrjet në forumet dhe aktivitetet ndërkombëtare.
2. Informacionet jepen ose publikohen me shkrim, në formë pamore, dëgjimore, elektronike ose në forma të tjera, për të gjithë të interesuarit, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

## **Neni 45**

### **Pjesëmarrja e publikut**

1. Në proceset e hartimit të strategjisë së pyjeve dhe kullotave, programit kombëtar, akteve ligjorë e nënligjorë, hartimit dhe zbatimit të projekteve të ndryshëm në fondin pyjor e kullor publik e privat, Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, sigurojnë pjesëmarrjen e publikut për vendimmarrjen në çështjet e mësipërme.
2. Planet e mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, si dhe projektet për zbatimin e tyre, hartohen dhe me pjesëmarrjen të banorëve të njësisë së qeverisjes vendore.
3. Pas përfundimit, brenda një afati kohor të mjaftueshëm, planet e mbarështimit vihet në dispozicion të publikut, me qëllim që ai të njihet dhe të japë mendimet përfundimtare para shqyrtimit dhe miratimit të tyre. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për projektet në zbatim të planeve të mbarështimit.
4. Procedurat e informimit, konsultimit dhe të përfshirjes ose jo të mendimeve të publikut në planin e mbarështimit dhe projekteve në zbatim të tij, zhvillohen në mënyrë transparente dhe të besueshme.
5. Mënyrat e informimit, të organizimit të konsultimeve, marrjes dhe dokumentimit të mendimeve si dhe afatet kohore të nevojshme për secilën fazë të procesit, deri në publikimin e vendimit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **Neni 46**

### **Shërbimi këshillimor**

1. Shërbimi këshillimor është pjesë e Ministrisë dhe ka për detyrë këshillimin e njësive të qeverisjes vendore, pronarëve privatë dhe përdoruesve të pyjeve dhe kullotave, për qeverisjen dhe mbrojtjen e pyjeve e kullotave në administrim, pronësi ose përdorim të tyre.
2. Shërbimi këshillimor ndihmon në proceset e hartimit dhe zbatimit të studimeve, projekteve, planeve të zhvillimi ose operacionalë, trajnimet e specialistëve të njësive të qeverisjes vendore, pronarëve privatë dhe përdoruesve të pyjeve e kullotave, informimin për ndryshimet dhe përmirësimet e akteve ligjorë e nënligjorë në fuqi.
3. Shërbimi këshillimor promovon praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare në administrimin e fondit pyjor dhe kullor kombëtar.
4. Shërbimi këshillimor organizon fushata informimi dhe ndërgjegjësimi në institucione arsimore, struktura të ndryshme shtetërore, subjekte privatë, për promovimin e vlerave të pyjeve e kullotave dhe të nevojës për mbrojtjen e zhvillimin e tyre.

## **KREU XIV FINANCIMET**

### **Neni 47**

#### **Burimet financiare**

1. Financimet e nevojshme për administrimin, qeverisjen, zhvillimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullor kombëtar, sigurohen nga:

- a. buxheti i shtetit;
- b. burimet e brendshme;
- c. donacione e grante të ndryshme.

2. Bazuar në ligjin organik të Buxhetit të Shtetit, çdo vit, Ministria, njësitë e qeverisjes vendore, Ministria e Financave dhe Ministria përgjegjëse për pushtetin vendor planifikojnë fondet e nevojshëm për fondin pyjor e kullor publik.

### **Neni 48**

#### **Përdorimi i burimeve financiare**

1. Burimet financiare në dispozicion të Ministrisë dhe të njërive të qeverisjes vendore për pyjet, kullotat dhe livadhet publike, përdoren për:

- a. investime të ndryshme në pyje e kullota, për administrimin, trajtimin dhe zhvillimin e tyre;
- b. mbrojtjen e faunës së egër, mjedisit dhe biodiversitetit;
- c. mbarështimin, inventarizimin dhe monitorimin e pyjeve dhe kullotave;
- d. parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve;
- e. mbështetjen e njërive të qeverisjes vendore dhe pronarëve privatë;
- f. studime, projekte e kërkime shkencore;
- g. punimet e mirëmbajtjes dhe të përmirësimit të gjendjes së pyjeve dhe kullotave;
- h. shtimin e sipërfaqes së pyjeve;
- i. ndërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e veprave të ujit të pijshëm për blegtorinë dhe infrastrukturës rrugore.

### **Neni 49**

#### **Ndarja e burimeve financiare të brendshme**

1. Të ardhurat që krijon nga pyjet, kullotat e livadhet publike, ndahen në raportin 70 % për vetë njësinë e qeverisjes vendore dhe 30 % derdhen në Buxhetin e Shtetit.

2. Të ardhurat e siguruara sipas pikës 1 të këtij neni përdoren vetëm për punime sipas përcaktimeve në pikat 1 të nenit 48 të këtij ligji.

## **KREU XV KERKIMI SHKENCOR**

### **Neni 50**

#### **Veprimtaria kërkimore e shkencore**

1. Veprimtaritë kërkimore e shkencore në fushën e pyjeve dhe kullotave kryhen nga institucione arsimore dhe shkencore, subjekte juridikë e fizikë, të cilët përmbushin kushtet dhe kriteret sipas legjislacionit të posaçëm në fushën kërkimore - shkencore.

2. Veprimtaritë kërkimore e shkencore kryhen në kuadrin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor, programeve shkencorë të vetë institucioneve si dhe të programeve të tjerë.

3. Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë me Ministrinë përgjegjëse për Arsimin për planifikimin dhe financimin e punës kërkimore e shkencore.

4. Institucionet arsimore dhe shkencore, personat juridikë e fizikë sigurojnë konsulencë, oponencë dhe asistencë teknike për fondin pyjor e kullor kombëtar.

### **Neni 51**

#### **Bazat eksperimentale dhe didaktike**

1. Institucionet arsimore, institucione të tjerë si dhe subjekte juridikë e fizikë, kanë të drejtë të ngrenë baza eksperimentale dhe didaktike, në fondin pyjor e kullor publik, për zhvillimin e veprimtarive kërkimore e shkencore, praktikave mësimore të nxënësve e studentëve dhe kualifikimin e specialistëve të pyjeve dhe kullotave.

2. Bazat eksperimentale dhe didaktike ngrihen me Urdhër të titullarit të njësisë së qeverisjes vendore për fondin pyjor dhe kullor në pronësi të saj, dhe me Urdhër të Ministrit për sipërfaqet në zonat e mbrojtura, në bazë të kërkesës së subjektit të interesuar.

## **KREU XVI SHËRBIMI PYJOR**

### **Neni 52**

#### **Organizimi i Shërbimit Pyjor**

1. Shërbimi Pyjor organizohet e vepron sipas parimeve të profesionalizmit, pavarësisë, transparencës, shërbimeve ndaj publikut, përgjegjësisë dhe korrektësisë për kryerjen e misionit dhe të detyrave të ngarkuara.

2. Shërbimi Pyjor përbëhet nga:

- a. Shërbimi Pyjor në Ministri, i cili harton politikat, aktet ligjore dhe nënligjore, shërbimin këshillimor dhe mbajtjen, administrimin e të dhënave të inventarit, planeve të menaxhimit dhe kadastrës kombëtare për fondin pyjor dhe kullor kombëtar.
  - b. Shërbimi Pyjor në njësinë e qeverisjes vendore që ka në pronësi pyjet dhe kullotat publike në territorin administrativ të tij.
3. Organizimi i shërbimit pyjor në Ministri përcaktohen me urdhër të Kryeministrit me propozimin e Ministrit.
  4. Organizimi i shërbimit pyjor të njësisë së qeverisjes vendore miratohet me Vendim të Këshillit Bashkiak, në plotësim të kritereve dhe funksioneve të strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, të miratuara në këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

### **Neni 53**

#### **Funksionet e shërbimit pyjor publik**

1. Shërbimi Pyjor në Ministri ka funksione të hartimit të politikave, të menaxhimit dhe të këshillimit për fondin pyjor dhe kullor kombëtar.
2. Shërbimi Pyjor funksionon në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe të akteve të tjerë ligjore e nënligjore në fuqi, që lidhen me fondin pyjor dhe kullor kombëtar.
3. Funksionet e shërbimit pyjor në njësinë e qeverisjes vendore janë:
  - a. administrimi, qeverisja, dhe zhvillimi i fondit pyjor e kullor publik, në përputhje me politikat dhe strategjitë e miratuara, legjislacionin në fuqi dhe detyrimet që lindin nga marrëveshjet, konventat, protokollat dhe traktatet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;
  - b. mbrojtja e fondit pyjor e kullor publik nga faktorët e ndryshëm biotikë dhe abiotikë dhe marrja e masave për përmirësimin e gjendjes;
  - c. përgatitja e projekt-planit vjetor buxhetor për të plotësuar nevojat financiare të operacioneve dhe masave teknike që parashikon të kryejë në sipërfaqet dhe fondin pyjor/kullor në pronësi, për vitin pasardhës buxhetor;
  - d. njoftimi i Inspektoriatit të Policisë Pyjore për shkeljet dhe dëmtimet e konstatuara në fondin pyjor dhe kullor në pronësi të saj;
  - e. informimi i publikut, grupeve të interesit dhe shoqatave të ndryshme mjedisore, për problemet që lidhen me administrimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor e kullor kombëtar;
  - f. shërbimi këshillimor, për trajtimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave në përdorim/pronësi të tyre, si pjesë integrale të fondit pyjor e kullor kombëtar;
4. Punonjësit e shërbimit pyjor publik pajisen me uniformë me shenja dalluese, dokument identifikimi dhe mjete të tjera teknike të nevojshme për kryerjen e detyrës. Caktimi i rregullave për mbajtjen, përbërjen, afatet e përdorimit e të zëvendësimit të uniformës për punonjësit e shërbimit pyjor publik dhe për inspektorët e policisë pyjore, caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## Neni 54

### Inspektoriati i Policisë Pyjore

1. Inspektoriati i Policisë Pyjor kryen funksione kontrolluese në fondin pyjor dhe kullor kombëtar.
2. Inspektoriati i Policisë Pyjor:
  - a. kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për pyjet, kullotat, zonat e mbrojtura, florën e faunën e egër, veprimtarinë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar nga subjektet private e publike, juridike e fizike, si dhe propozon heqjen e certifikates/ zgjidhjen e kontratës në rastet kur subjektet veprojnë në kundërshtim me këto dispozita;
  - b. parandalon, zbulon dhe ndëshkon rastet e dëmtimit, pushtimit, shpërdorimit, tjetërsimit, shkretimeve dhe degradimit të pyjeve, të tokës pyjore, kullotave dhe livadheve;
  - c. Bashkëpunon me strukturat e ngarkuara me këtë ligj dhe ligje të posaçëm, për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve;
  - d. Parandalon dhe merr masa në rastet e shfrytëzimit dhe të tregtimit të paligjshëm të materialit drusor, të prodhimeve pyjore e jopyjore, të florës e faunës së egër, të bimëve mjekësore, aromatike, eterovajore e tanifere natyrore, të prodhimeve pyjore e jopyjore të fondit pyjor kombëtar, si dhe çdo veprimtari tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj;
  - e. Bën kallëzim penal për shkeljet që parashikohen në Kodin Penal si vepra penale në fushën e pyjeve, kullotave, zonat e mbrojtura e pyjet me funksion të veçantë,
  - f. Vendos dënimin administrativ me gjobë, dënimet plotësuese dhe pezullon veprimtarinë e ushtruar nga çdo kundërvajtës;
  - g. Bashkëpunon dhe mbështet veprimtarinë e shërbimit pyjor të njësisë së qeverisjes vendore;
  - h. Bashkëpunon dhe bashkërendon me inspektoriatet e tjerë dhe me Policinë e Shtetit dhe me organet e qeverisjes vendore për parandalimin, kontrollin dhe ndëshkimin e kundërvajtësve në fushën e pyjeve dhe kullotave.
3. Inspektoriati i Policisë Pyjore është pjesë e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve dhe organizimi dhe funksionimi miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.
4. Inspektorët e Policisë Pyjore gjatë kryerjes së detyrës gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore.
5. Inspektorët e Policisë Pyjore pajisen me uniformë me shenja dalluese, me dokument identifikimi dhe me mjete të tjera teknike, të nevojshme për kryerjen e detyrës. Çaktimi i rregullave për mbajtjen, përbërjen, afatet e përdorimit e të zëvendësimit të uniformës, caktohen sipas pikës 4 të nenit 53 të këtij ligji.



**KREU XVII**  
**KUNDERVAJTJET NE PYJE DHE KULLOTA**

**Neni 55**

**Kundërvajtjet administrative**

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë:

1.1 Kundërvajtjet në fondin pyjor kombëtar:

- a. prerja pa damkë e drurëve apo prerja pa leje e pyjeve, filizërisë dhe e fidanëve në fidanishte, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë nga 80.000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100.000 (njëqind mijë) lekë, ndërsa kur pasojat janë të rënda dënohet me gjobë me vlerë nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë;
- b. grumbullimi i prodhimeve drusore dhe jodrusore, si fashina, shkarpa, thupra, cungje, petavra, rrënjë drurësh, kucka, hunjë, bandiera, lëvore, lule, fruta, fara, sytha, bisqe, degë, drurë dekorativë, shpatulla, kalema, hala, boçe, gjethe, zhuka, kallamishte, rrëshirë, plisa, bar, rrënjë, zhardhokë, qepë, kërpudha, myshqe, humus, lëgushë, torfë, dhé, gurë, zhavorr dhe rërë, pa lejen përkatëse, dënohet me gjobë me vlerë nga 5.000 (pesë mijë) deri në 10.000 (dhjetë mijë) lekë;
- c. nxjerrja e rrënjëve të shqopës, bushit, maresë dhe prerja e thuprës së shelgut e të llojeve të tjera të drurëve pyjorë, gjatë periudhës së vegetacionit, dënohet me gjobë me vlerë nga 20.000 (njëzet mijë) deri në 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë;
- d. mbledhja e prodhimeve të dyta, si bimë mjekësore, eterovajore e tanifere, bimë të rralla e të kërcënuara e të tjera të kësaj natyre, jashtë periudhës teknike të vjeljes dënohet me gjobë me vlerë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 70 000 (shtatëdhjetë) mijë e kur mbledhja bëhet me mënyra që sjellin degradimin, kërcënimin, rrallimin, zhdukjen apo dobësimin e funksioneve të tyre, dënohet me gjobë me vlerë nga 80.000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100.000 (njëqind mijë) lekë;
- e. kullotja e bagëtive në pyjet e rinj, në filizëri, në pyllëzime e reja, në fidanishte, në ngastrat gjenetike e eksperimentale dhe në pyjet mbrojtës, dënohet me gjobë me vlerë nga 5.000 (pesë mijë) deri në 10.000 (dhjetë mijë) lekë;
- f. krasitja për gjethe, kositja dhe grumbullimi i barit në fondin pyjor, pa lejen përkatëse, dënohet me gjobë me vlerë nga 8.000 (tetë mijë) deri në 10.000 (dhjetë mijë) lekë;
- g. ndërhyrjet me punime të ndryshme në ligatinat dhe dunat bregdetare, pjesë përbërëse të fondit pyjor kombëtar, pa lejen përkatëse, dënohet me gjobë me vlerë nga 50.000 (tridhjetë mijë) deri në 70.000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
- h. ndërhyrjet për pyllëzime apo pasurimin dhe përmirësimin e bimësisë së tokave pyjore, pa lejen përkatëse, dënohet me gjobë me vlerë nga 20.000 (njëzet mijë) deri në 40.000 (dyzetë mijë) lekë;
- i. ndezja e zjarreve jashtë vendeve të caktuara, dënohet me gjobë me vlerë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

- j. prishja e shenjës së damkës në dru apo përdorimi i çekiç-damkës nga persona të pa autorizuar dhe nga një zonë pyjore në tjetrën, dënohet me gjobë me vlerë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;
- k. ndërtimi i furrave të gëlqeres dhe i kaminave të qymyrit të drurit në fondin pyjor, pa lejen përkatëse, dënohet me gjobë me vlerë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;
- l. ngritja e ndërtimeve të thjeshta, gardhimeve, kampingjeve, brenda territoreve të rrethuara të fondit pyjor dënohet me gjobë me vlerë nga 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe kur kryhet në fondin pyjor të deklaruar me funksion mbrojtës e të veçantë, dënohet me gjobë me vlerë nga 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;
- m. parkimi i automjeteve, vendosja e rulotëve në pyjet me funksion mbrojtës e të veçantë, në parqet kombëtare, në rezervatet e mbarështimit të florës e të faunës së egër, në fidanishtet pyjore ose në vendet e tjera të fondit pyjor, me rëndësi të veçantë, pa lejen përkatëse, dënohet me gjobë me vlerë nga 5.000 (pesë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;
- n. ndryshimi i zërit kadastral nga pronari privat apo njësia e qeverisjes vendore, në kundërshtim me procedurat ligjore në fuqi, dënohet me gjobë me vlerë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;
- o. mosraportimi nga njësia e qeverisjes vendore dhe pronari privat, i ndryshimeve përkatëse në fondin pyjor e kullësor kombëtar dhe në tokën pyjore, ngarkon me përgjegjësi titullarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe pronarin privat, dënohet me gjobë me vlerë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;
- p. transferimi i të drejtave të siguruara nga kontrata e trajtimit, shfrytëzimit dhe përdorimit në fondin pyjor kombëtar, dënohet me gjobë me vlerë nga 80.000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100.000 (njëqind mijë) lekë;
- q. transporti me automjete apo mjete të tjera i materialit drusor nga pylli dhe prej shesheve të depozitimit për në qendrat e përpunimit e të shitjes, i pashoqëruar me dokumentacionin që provonon origjinën e tij, dënohet me gjobë me vlerë nga 300.000 (treqind mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;
- r. tregtimi i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera të pyllit, të infektuara nga sëmundjet, barërat e këqija e parazitare ose të prekura nga insektet, dënohet me gjobë me vlerë nga 80.000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- s. mos ripyllëzimi i sipërfaqeve ose brezave pyjorë pas prerjeve rrah të llojeve që nuk ripërtërihen në rrugë natyrore, si dhe mos pyllëzimi/ripyllëzimi nga ana e personave fizikë/juridikë për sipërfaqe që hiqen nga fondi pyjor dhe kullësor kombëtar dënohen me gjobë me vlerë nga 180 000 (njëqind e tetë dhjetë mijë) deri 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha.
- t. eksporti i lëndës së drurit të papërpunuar, lëndës së ndërtimit, druve të zjarrit dhe asortimentet që rrjedhin nga tjetërsimi i tyre, si edhe qymyrit të drurit, dënohet me gjobë me vlerë nga 100 000 (njëqind mijë) deri 200 000 (dyqind mijë) lekë.

## 1.2 Kundërvajtjet në fondin kullësor kombëtar:

- a. kullotja pa kontratë dhe në kullota të tjera, veç atyre të specifikuar në kontratë, dënohet me gjobë me vlerë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.
- b. kositja e barit në livadhe, pa lejen përkatëse, dënohet me gjobë me vlerë nga 30.000 (tridhjetë mijë) deri në 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
- c. kullotja e bagëtive në ngastrat eksperimentale, në sipërfaqet ku kryhen punime përmirësuese ose që janë të degraduara e të lëna pushim, dënohet me gjobë me vlerë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.
- d. ndryshimi i destinacionit të veprave të ujit të pijshëm për blegtorinë dhe dëmtimi i infrastrukturës dënohet me gjobë me vlerë nga 30.000 (tridhjetë mijë) deri në 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
- e. ndërhyrjet për pasurimin dhe përmirësimin e bimësisë dhe të kapacitetit të kullotave e livadheve, pa lejen përkatëse, dënohet me gjobë me vlerë nga 20.000 (njëzetë mijë) deri në 40.000 (dyzetë mijë) lekë.
- f. përdorimi i plehrave kimike dhe i pesticideve, pa lejen përkatëse, dënohet me gjobë me vlerë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.
- g. prerja e drurëve të veçuar dhe e shkurreve, pa lejen përkatëse, dënohet me gjobë me vlerë nga 30.000 (tridhjetë mijë) deri në 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.
- h. pastrimi i kullotave dhe i livadheve, pa lejen përkatëse, dënohet me gjobë me vlerë nga 20.000 (njëzetë mijë) deri në 40.000 (dyzetë mijë) lekë.

### 1.3 Kundërvajtjet në fondin pyjor dhe kullosor kombëtar:

- a. ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i veprimtarive që shkaktojnë degradimin dhe gërryerjen e tokës, dënohet me gjobë me vlerë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 300 000 (treqind mijë) lekë.
- b. mos njoftimi i Inspektoriatit të Policisë Pyjore nga njësia e qeverisjes vendore për shkeljet dhe dëmet e konstatuara, ngarkon me përgjegjësi kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe dënohet me gjobë me vlerë 100 000 (dhjetë mijë) lekë, ndërsa për fondin pyjor/ kullosor privat ngarkon me përgjegjësi pronarin dhe dënohet me gjobë me vlerë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
- c. nxjerrja e gurëve, plisave, rrënjëve, cungjeve, marrja e dheut, rërës dhe zhavorrit, kur pasojat materiale janë të lehta, pa lejen përkatëse dënohet me gjobë me vlerë nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) deri në 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë dhe kur pasojat janë të rënda dënohet me gjobë me vlerë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 300 000 (treqind mijë) lekë;
- d. prishja, fshirja ose dëmtimi i shenjave kufidëftuese, gjeodezike e topografike, i tabelave paralajmëruese apo treguese, të vendosura në fondin pyjor e kullosor kombëtar, dënohet me gjobë me vlerë nga 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) deri në 20.000 (njëzet mijë) lekë;

- e. hedhja e mbetjeve brenda sipërfaqes së fondit pyjor e kullësor kombëtar dhe jashtë vendeve të caktuara, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë me vlerë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 300 000 (treqind mijë) lekë dhe kur pasojat janë të rënda dënohet me gjobë me vlerë nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë;
  - f. shkarkimet e kimikateve, të ujërave të ndotur industrialë, në fondin pyjor e kullësor kombëtar, dënohet me gjobë me vlerë nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.
  - g. Gërrmimi për karriera të çdo lloji që përdorin lëndë plasëse, pa lejen përkatëse, dënohet me gjobë me vlerë nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.
  - h. mosrealizimi i masave apo punimeve të parashikuara në projekte në mjedisin pyjor dhe kullësor dënohet me gjobë me vlerë nga 300.000 (treqind mijë) lekë deri në 500.000 (pesëqind mijë) lekë.
  - i. Mosdërgimi i hartës vjetore e shfrytëzimit brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 18 të nenit 32, ngarkon me përgjegjësi titullarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe dënohet me gjobë me vlerë nga 300.000 (treqind mijë) lekë deri në 500.000 (pesëqind mijë) lekë.
2. Kriteret për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit.

## **Neni 56**

### **E drejta e procedimit**

1. Të drejtën e procedimit administrativ për zbatimin e këtij ligji e ka Inspektoriati i Policisë Pyjore.
2. Shërbimit pyjor i njësisë së qeverisjes vendore, në rastet kur konstaton shkelje të dispozitave të këtij ligji:
  - a. mban proces-verbal në momentin e konstatimit të kundërvajtjes;
  - b. dokumenton me të gjithë mjetet e mundshme, foto, regjistrime fonike, video;
  - c. njofton menjëherë Inspektoriatin e Policisë Pyjore, për të kryer procedurat e mëtejshme.
3. Procesverbali nënshkruhet nga hartuesi i tij, dëshmitarët nëse ka të tillë dhe kundërvajtësi. Procesverbali është i vlefshëm edhe vetëm me nënshkrimin e hartuesit.
4. Proces-verbali i mbajtur, i dorëzohet zyrtarisht, inspektoriatit të policisë pyjore referuar kompetencës territoriale.
5. Përmbajtja dhe modeli i procesverbalit për kundërvajtjet në pyje dhe kullota miratohet me urdhër të ministrit.

## **Neni 57**

### **Vlerësimi i dëmit**

1. Kryerja e vlerësimit të dëmit të shkaktuar në fondin pyjor dhe kullor kombëtar është detyrë e Inspektoriatit të Policisë Pyjore dhe Shërbimit Pyjor të njësisë së qeverisjes vendore.
2. Inspektoriatit i Policisë Pyjore njofton njësinë e qeverisjes vendore dhe pronarin privat, për dëmin e vlerësuar prej tij dhe u përcjell atyre të gjithë praktikën përkatëse.
3. Njësia e qeverisjes vendore dhe pronari privat kërkojnë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga kundërvajtësi, në fondin pyjor e kullor në pronësi të tyre, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Vlera e dëmit të shkaktuar në pyje dhe kullota përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave referuar pikës 5 të nenit 32 të këtij ligji.

## **Neni 58**

### **Vendimi për kundërvajtjet**

1. Inspektori i Policisë Pyjore, merr vendimin për dënimin administrativ për kundërvajtjet e parashikuara në nenin 55 të këtij ligji.
2. Vendimi për kundërvajtjen administrative përmban dënimin me gjobë për kundërvajtësin/t dhe dënimet plotësuese si mëp poshtë:
  - a. Sekuestrimin e mjeteve dhe automjeteve që kanë shërbyer për kryerjen e kundërvajtjes;
  - b. Sekuestrimin e çdo vlere monetare dhe material, lënde drusore dhe jodrusore, bime medicinale, florë dhe faunë, të përfituar nëpërmjet kundërvajtjes.
  - c. pezullimin e veprimtarisë dhe çmontimin e instalimeve.
3. Inspektoriatit i Policisë Pyjore ia dorëzon në ruajtje të përkohëshme mjetet dhe materialet e sekuestruara sipas pikave “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni njësisë së qeverisjes vendore ose pronarit privat sipas pronësisë, deri sa vendimi për kundërvajtjen administrative merr formë të prerë. Dorëzimi i mjeteve dhe materialeve të sekuestruara bëhet me procesverbal të nënshkruar midis palëve.
4. Mjetet dhe materialet e sekuestruara sipas pikave “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni pasi vendimi për kundërvajtjen administrative merr formë të prerë, kalojnë për llogari të njësisë së qeverisjes vendore ose pronarit privat, në varësi të formës së pronësisë të fondit pyjor e kullor dhe administrohen prej tyre sipas legjislacionit në fuqi.
5. Kur kundërvajtja administrative kryhet në Zonat e Mbrojtura, Inspektoriatit i Policisë Pyjore ia dorëzon në ruajtje të përkohëshme, mjetet dhe materialet e sekuestruara sipas pikave “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni, Administratës së Zonës së Mbrojtur dhe pasi vendimi për kundërvajtjen administrative merr formë të prerë, Administrata e Zonës së Mbrojtur i administrohet sipas legjislacionit në fuqi. Dorëzimi i mjeteve dhe materialeve të sekuestruara bëhet me procesverbal të nënshkruar midis palëve

## **Neni 59**

### **Detyrimi për kallëzim penal**

1. Njësitë e qeverisjes vendore, pronarët privatë, Policia Pyjore, administruesit, personat juridikë e fizikë dhe strukturat e tjera shtetërore, kanë detyrimin ligjor të bëjnë kallëzim penal në rastet kur në përputhje me dispozitat e Kodit Penal, dëmi i shkaktuar konsiderohet vepër penale.

#### **Neni 60**

##### **Ankimi dhe ekzekutimi i sanksioneve administrative**

1. Ndaj vendimit të dhënë në zbatim të nenit 58 të këtij ligji, bëhet ankim, në përputhje me ligjin në fuqi për inspektimin.
2. Procedurat e ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.

### **KREU XVIII**

#### **DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE**

#### **Neni 61**

##### **Skema e liçencimit FLEGT**

1. Skema e liçencimit FLEGT përbën një grupim rregullash dhe procedurash për importin e disa produkteve të drurit, e cila zbatohet nëpërmjet marrëveshjeve të partneritetit me shtetet që prodhojnë dur/lëndë druri.
2. Rregullat dhe procedurat për zbatimin e skemës së liçencimit FLEGT miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit përgjegjës për pyjet.

#### **Neni 61**

Transferimi i pyjeve dhe kullotave në pronësi të njërive të qeverisjes vendore, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 62**

##### **Shfuqizimi i dispozitave ligjore**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar dhe ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullorosor”, i ndryshuar.

#### **Neni 63**

##### **Vazhdimi i efekteve juridike të disa akteve nënligjore**

3. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji aktet nënligjore të mëposhtme vazhdojnë të kenë efekt juridik sikur të kenë dalë në zbatim të këtij ligji deri në shfuqizimin e tyre me akt nënligjor të veçantë:
  - a. Vendim i Këshillit të Ministrave nr 391 date 21.06.2006 “Per percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” i ndryshuar.

- b. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.48, datë 31.1.2007 “Për përcaktimin e rregullave për mbajtjen, përbërjen, afatet e përdorimit e të zëvendësimit të uniformës dhe të pajisjeve e të mjeteve të tjera, në përdorim të punonjësve të Shërbimit Pyjor”.
- c. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 21.6.2006 “Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore”.
- d. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 22, dt. 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të administrimit të pyllit komunal”.
- e. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 394, datë 21.6.2006 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e prodhimeve të tjera, pyjore e jopyjore”.
- f. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 19.12.2007 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje”.
- g. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1374, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”.
- h. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1354, datë 10.10.2008 “Për kriteret për caktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar në fondin kullosor”.
- i. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1353, datë 10.10.2008 Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”.
- j. Udhëzim nr.3 datë 22.06.2007 i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave “Mbi procedurën e miratimit të planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave komunale”.
- k. Udhëzim nr. 4, datë 12.09.2008 i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave “Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor”
- l. Rregullore nr. 4, datë 19.09.2008 e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave Për funksionimin e komisionit teknik për shqyrtimin e planeve të mbarështimit të pyjeve
- m. Udhëzim nr. 5, datë 13.9.2006 i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave e nënngastrave për shfrytëzim, të damkosjes së drurëve, të prerjes e asortimit, të transportit e stivosjes së materialit drusor në anë të rrugës
- n. Urdhër nr. 360, datë 19.09.2008 i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave Për ngritjen e komisionit teknik për shqyrtimin e planeve të mbarështimit të pyjeve
- o. Udhëzim nr. 4, datë 10.4.2008 i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënie të tyre për kullotje e kositje bari.
- p. Udhëzim nr. 4 ,date 22.4.2013 i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave ”Per përcaktimin e kriterëve të konkurimit dhe procedurën e dhenjes në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor kullosor publik”.
- q. Udhëzim nr. 4, datë 23.8.2007 i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave “Për organizimin e ankandit të shitjes së lëndës drusore në pyjet publike”, i ndryshuar.

r.Urdhëri nr.1959, datë 10.11.2014, i Ministrit të Mjedisit “Për procedurat e eksportit të produkteve drusore të përpunuara dhe ndalimin e përkohshëm të eksportit të qymyrit të drurit dhe kufizimin për eksport të druve të zjarrit”

#### **Neni 64**

##### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që në zbatim të neneve 4, pika 5; 5, pika 5; 8, pika 4; 12, pika 4; 14, pika 6; 26, pika 4; 28, pika 4; 29, pika 2; 30, pika 1; 32, pikat 2 dhe 5; 36, pika 6; 45, pika 5; 53, pika 4; 55, pika 2, të nxjerrë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për administrimin e fondit pyjor e kullosor publik, që në zbatim të neneve 6, pika 2; 16, pika 3; 23, pika 3; 56, pika 5; 8, pika 3; 9, pika 2; 19, pika 2; 21, pika 2; 23, pika 6; 24, pika 4; 27, pika 4; 34, pikat 4 dhe 6 të nxjerrë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet nënligjore në zbatim të tij.

3. Ngarkohet ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri që në zbatim të nenit 41, pika 5 të nxjerrin Udhëzimin brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

#### **Neni 65**

##### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet juridike nga data 1 Korrik 2016.

**K R Y E T A R I**

**ILIR META**